EPOKA E RE
E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5907
E premte, 18 tetor 2019
çmimi 0.40 €

## Akreditohet Qendra për Studime Universitare e FSK-së FAQE 5



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHPEND EMINI FAQE 4-5

# RINUMËRIMI NUK E DËMTON PROCESIN ZGJEDHOR



Drejtori i Institutit të Demokracisë për Zhvillim (D4D), Shpend Emini, ka bërë me dije se rinumërimi i qindra kutive të votimit nuk e dëmton procesin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se çdo dyshim rreth procesit zgjedhor duhet të vlerësohet dhe të rishikohet nga KQZ-ja. Sipas tij, organet përgjegjëse duhet të punojnë dhe veprojnë në ato raste kur vërtetohet manipulim ose kur komisionarët kanë ndërhyrë në mënyrë të jashtëligjshme në fletëvotim apo në formular. Emini ka treguar se për t'u ikur manipulimeve të mundshme nga komisionarët, numërimi i votave duhet të centralizohet

## Prokuroria pranon ekspertizën për vdekjen e Astrit Deharit, nuk dihet përmbajtja FAQE 3



Prokurori i Shtetit të enjten ka pranuar raportin përfundimtar të ekspertizës nga Qendra Universitare e Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor 2016. Kryeprokurori i Prizrenit, Admir Shala, në një konferencë për medie ka bërë me dije se zarfi i pranuar është i mbyllur dhe nuk dihet përmbajtja e ekspertizës së institutit zviceran. Sipas Shalës, ky raport do t'i dorëzohet prokurorit të rastit dhe familjes Dehari pasi të përkthehet në gjuhën shqipe



## KQZ-ja vendos të rinumërohen edhe 530 vendvotime

FAQE 3

## AKTUALE



### KANDIDATJA PËR DEPUTETE, SELVIJE HALIMI, KËRKON QË TË KETË RINUMËRIM TË VOTAVE NJË NGA NJË F. 7

### KADRI KASTRATI FTOHET PËR INTERVISTIM NGA GJYKATA SPECIALE F. 7

### KONTESHA E WESSEXIT BËN THIRRJE PËR AKOMODIMIN E VIKTIMAVE TË DHUNËS SEKSUALE F. 7



## EKONOMI



### 'AUTO MITA' DHE 'GALVAZING' CERTIFIKOHEN SI OPERATORË EKONOMIKË TË AUTORIZUAR F. 9

### GUVERNATORI MEHMETI TAKOI ZYRTARËT E THESARIT AMERIKAN DHE ATA TË FMN-së F. 9

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

## Kurti takohet me zyrtarë të Parlamentit britanik



PRISHTINË, 17 TETOR - Kandidati i Lëvizjes Vetëvendosje për kryeministër të Kosovës, Albin Kurti të enjten në Londër është takuar me zyrtarë të Parlamentit britanik, për t'i diskutuar marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve.
Kurti gjatë kësaj vizite në Parlamentin britanik, ka takuar John Cryer, kryesuesin e Grupit Parlamentar të Laburistëve, Khalid Mahmood, ministër i Punëve të Jashtme në hije dhe Kastriot Berberi, këshilltar komunal në Waltham Forest.
Kurti në një postim në llogarinë e tij në Facebook ka shkruar se me ta ka diskutuar për marrëdhëniet e mira bilaterale midis dy vendeve, situatën socio-ekonomike në Kosovë, për ndryshimet politike pas fitores së LVV-së në zgjedhjet e 6 tetorit, si dhe për sfidat nëpër të cilat po kalon Britania e Madhe lidhur me Brexit-in.
"Ministri i Punëve të Jashtme në hije, Khalid shprehu vullnetin për bashkëpunim dhe për të përkrahur qeverinë e ardhshme në fushën e investimeve, tregtisë e drejtësisë, si dhe për të ndihmuar e përkrahur Kosovën për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Në këtë takim isha bashkë me deputetet Saranda Bogujevci e Fitore Pacolli si dhe me Agim Morinën, koordinator i Qendrës së VETËVENDOSJE!-s në Britani të Madhe", ka shkruar Kurti.

# Leyen: Nuk ka shenja pozitive për hapjen e negociatave me Shqipërinë

Presidentja e zgjedhur e Komisionit Evropian, Urusula von der Leyen tha se për fat të keq nuk ka shenja pozitive për një vendim për fillimin e negociatave të pranimit në BE për Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore

BRUKSEL, 17 TETOR - Këshilli Evropian është mbledhur të enjten në Bruksel ku temë kryesore diskutimi janë Brexit-i, negociatat me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe Turqia. Presidentja e zgjedhur e Komisionit Evropian, Urusula von der Leyen tha se është zhgënjyese dhe ndjen keqardhje për shtyrjen e zgjerimit të BE-së.
Sipas der Leyen sot nuk ka shenja që të këtë vendim për zgjerimin e BE-së.
"Fatkeqësisht, nuk ka shenja pozitive për një vendim për fillimin e negociatave të pranimit në BE për Shqipërinë dhe Maqedoninë Veriore. Më vjen shumë keq sepse besoj me vendosmëri se të dy vendet kanë bërë përpjekje të mëdha për të ecur më afër standardeve evropiane dhe meritojnë një sinjal pozitiv", theksoi von der Leyen.
Në këtë mënyrë, numri një i institucioneve të Bashkimit Evropian ka konfirmuar se qëndrimi i Francës kundër hapjes së negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut nuk do të ndryshojë.
Gjithashtu, komisionarja në ikje për Politikat e Jashtme të BE-së, Federika Mogerini bënë me dije se të enjten do të diskutohet në Këshillin e Evropës çështja e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, por nuk jep detaje lidhur me vendimin.
Kancelarja gjermane, Angela Merkle ka thënë të enjten se shanset për arritjen e një vendimi të përbashkët në samitin e BE-së për dhënien e datës për fillimin e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë nuk janë të mira. Gjatë fjalimit në Bundestag, para udhëtimit për në Bruksel, Merkel ka deklaruar se "ne kemi përgjegjësi ndaj këtyre vendeve dhe mendoj se kemi llogari që këtyre dy vendeve t'u japim perspektivë evropiane".
Në përgjithësi, Merkel e vlerësoi samitin në Bundestag si të pasigurt në rezultatet e tij. "Nuk mund të them se si do të përfundojë ky samit", tha ajo në Bundestag.



Një ditë më parë Merkel i kishte relativizuar pohimet, se mes Gjermanisë dhe Francës ka diferenca të mëdha në drejtim të perspektivës së anëtarësimit të të dy vendeve ballkanike. Të dyja palët e mbështesin perspektivën e anëtarësimit, tha Merkeli në Tuluz të mërkurën. Ajo e mbështet madje dëshirën e Francës për një reformim të procesit të anëtarësimit që duhet të jetë transparent dhe i kthyeshëm në rast të zhvillimeve negative. Sipas Merkelit, bisedimet e anëtarësimit duhet të fillojnë, kur të sqarohen çështje të caktuara. Por në këtë rrugë "ka disa nuanca të ndryshme", tha ajo.
Një ditë më parë, presidenti i Francës Emanuel Macron deklaroi se BE-ja duhet të reformohet dhe më pas të vendosë për Shqipërinë dhe Maqedoninë.
"Mendoj që duhet ta reformojmë këtë procedurë që është aktualisht e pakthyeshme, kemi dhe gjëra të çuditshme në këtë proces. Për shembull kemi lëvizjen e lirë përpara se të hapen negociatat. Kemi lëvizjen e lirë me Shqipërinë pa hapur negociatat dhe kjo është një lloj marrëdhënie e çuditshme. Në mirëbesim kemi dhënë lëvizjen e lirë dhe kemi mijëra e mijëra persona që kërkojnë azil", deklaroi Macron.
Ndërkohë, presidenti i Parlamentit Evropian David Sassoli është shprehur "pro" çeljes së negociatave për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në hapje të samitit të liderëve të BE-së që ka zhvilluar punimet të enjten në Bruksel, Sassoli deklaroi se Parlamenti Evropian mbështet hapjen e menjëhershme të negociatave të pranimit dhe se do jetë e vështirë të shpjegohet pse po vonohet kjo gjë.
"Ne mbështesim hapjen e menjëhershme të negociatave të pranimit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë. Komisioni Evropian është në favor të kësaj dhe ne do ta kemi të vështirë t'iu shpjegojmë njerëzve të atyre vendeve pse e vonojmë atë", deklaroi Sassoli.

## Shqipëria drejton takimin e ministrave të mbrojtjes së Evropës Juglindore

Tiranë, 17 tetor - Në cilësinë e vendit që mban kryesimin e Sekretariatit të Iniciativës së ministrave të mbrojtjes të Evropës Juglindore (SEDM), Ministria e Mbrojtjes drejtoi takimin e ministrave të mbrojtjes, SEDM, i cili u zhvillua në Bukuresht të Rumanisë.
Me pjesëmarrjen e 16 vendeve anëtare, përfaqësues të lartë nga NATO-ja, si dhe nga organizata të tjera ndërkombëtare si UN dhe RACVIAC, ky takim u drejtua nga zëvendësministri shqiptar i Mbrojtjes, Petro Koçi, në cilësinë e kryetarit të Sekretariatit të SEDM.
Në fillim të këtij takimi, Koçi prezantoi prioritetet, që do t'i ketë Shqipëria gjatë kryesimit të kësaj iniciative duke vënë theksin te "Politika e dyerve të hapura" për çdo shtet tjetër në rajon dhe më gjerë, i cili aspiron të jetë pjesë e këtij forumi me fokusin kryesor promovimin e sigurisë dhe mbrojtjes.
U rikonfirmua gjithashtu, si një nga prioritetet kryesore të Iniciativës angazhimi për forcimin e fqinjësisë së mirë ndërmjet vendeve të rajonit si dhe bashkëpunimi në kuadër të trajnimeve dhe stërvitjeve të përbashkëta.
Më tej, Ministeriali vijoi me qëndrimet e vendeve anëtare dhe fokusin që do të ketë kjo iniciative në të ardhmen, mbi angazhimin e përbashkët për promovimin e paqes dhe stabilitetit ne Evropën Juglindore.




EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Admir Shala, ka mbajtur konferencë për medie

# Prokuroria pranon ekspertizën për vdekjen e Astrit Deharit, nuk dihet përmbajtja

**Prokurori i Shtetit të enjten ka pranuar raportin përfundimtar të ekspertizës nga Qendra Universitare e Mjekësisë Ligjore në Lozanë të Zvicrës për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor 2016. Kryeprokurori i Prizrenit, Admir Shala, në një konferencë për medie ka bërë me dije se zarfi i pranuar është i mbyllur dhe nuk dihet përmbajtja e ekspertizës së institutit zviceran. Sipas Shalës, ky raport do t'i dorëzohet prokurorit të rastit dhe familjes Dehari pasi të përkthehet në gjuhën shqipe**



EPOKA E RE Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 17 TETOR - Kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Admir Shala, të enjten ka bërë me dije se Prokuroria e Shtetit ka pranuar raportin përfundimtar për rastin e vdekjes së Astrit Deharit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor të vitit 2016.

Në një konferencë për medie, Shala ka treguar se zarfi i pranuar është i mbyllur dhe nuk dihet përmbajtja e ekspertizës së institutit zviceran. Ai ka thënë se ky raport do t'i dorëzohet prokurorit të rastit dhe familjes Dehari pasi të përkthehet në gjuhën shqipe. "Prokuroria e Shtetit njofton se më 17 tetor kemi pranuar raportin përfundimtar të ekspertizës për rastin Dehari nga Instituti në Zvicër përmes Ambasadës së Zvicrës në Kosovë. Ky raport është me zarf të mbyllur dhe akoma nuk e dimë përmbajtjen e tij. Këto janë vulat e pranimit, ambasada e ka pranuar dje, ndërsa sot (e enjte) është dorëzuar në Prokurorinë e Shtetit. Ky raport do t'i dorëzohet prokurorit të rastit dhe familjes së Astrit Deharit pasi të përkthehet në gjuhën shqipe", ka thënë Shala. Ai u ka bërë thirrje medieve që me përmbajtje dhe profesionalizëm të pritet publikimi dhe rezultati i këtij raporti. "Prokurori i Shtetit do t'ju njoftojë me kohë për datën dhe orën e publikimit të raportit në fjalë. Lus mediat që deri në publikimin e raportit të përmbahen nga deklarimet që mund ta dëmtojnë rastin", është shprehur kryeprokurori Shala.

Ndërsa Lëvizja Vetëvendosje (LV) nëpërmjet një komunikate për medie të enjten ka kërkuar nga Prokuroria e Shtetit që sa më parë t'i përgjigjet kërkesës duke ia dorëzuar familjes së Astrit Deharit dhe përfaqësuesit ligjor e avokatit mbrojtës të familjes Dehari raportin në gjuhën origjinale. Po sipas LV-së, raporti duhet të publikohet në versionin origjinal dhe i përkthyer në gjuhën shqipe. Vetëvendosja ka vlerësuar se Prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë do të duhej ta njoftonin opinionin publik me kohë për arritjen e këtij raporti, por një gjë e tillë ndodhi vetëm pas kërkesave të njëpasnjëshme të avokatit mbrojtës e përfaqësuesit ligjor të familjes Dehari. "Sot u informuam nga konferenca për media e Prokurorisë së Kosovës se raporti i ekspertizës së pavarur ndërkombëtare nga Qendra Spitalore Universitare në Lozanë të Zvicrës, i kërkuar nga familja Dehari dhe i lejuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, ka mbërritur në Kosovë. Edhe pse Prokuroria dhe Ministria e Drejtësisë duhet ta kishin njoftuar opinionin publik me kohë për arritjen e këtij raporti, vetëm pas kërkesave të njëpasnjëshme të avokatit mbrojtës e përfaqësuesit ligjor të familjes si dhe kërkesave të familjes Dehari, më në fund sot u deklaruan për pranimin e raportit të lartcekur. Kërkojmë nga Prokuroria që sa më parë t'i përgjigjet kërkesës duke ia dorëzuar familjes Dehari dhe përfaqësuesit ligjor e avokatit mbrojtës të familjes Dehari, raportin në gjuhën origjinale si dhe ta publikojë atë në versionin origjinal dhe të përkthyer në gjuhën shqipe", është thënë në komunikatën për medie të Vetëvendosjes.

Aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje, Astrit Dehari, është gjetur i vdekur në qelinë e vej në Qendrën e Paraburgimit në Prizren më 5 nëntor të vitit 2016. Astrit Dehari po mbahej në paraburgim nën dyshimin se ishte pjesëmarrës në sulmin me mjet shpërthyes në objektin e Kuvendit të Kosovës.

## KQZ-ja vendos të rinumërohen edhe 530 vendvotime




PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka miratuar të enjten kërkesën e Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve për rinumërimin edhe të 530 vendvotimeve. Pasi që Burim Ahmetaj, koordinator në QNR, ka arsyetuar kërkesën për rinumërim, propozimi i tij ka marrë votat e anëtarëve të KQZ-së.

Rinumërimi i këtyre vendvotimeve ka filluar të enjten. Po të hënën ka përfunduar rinumërimi i 314 vendvotimeve, pas rekomandimeve të QNR-së për disa parregullsi gjatë mbushjes së formularëve.

Kryetarja e KQZ-së, Valdete Daka, në mbledhjen e këtij institucioni u ka bërë thirrje policisë dhe Prokurorisë ta monitorojnë procesin e rinumërimit të votave.

Pas kësaj thirrje të kryetares së KQZ-së, Prokuroria dhe policia kanë shkuar për ta parë nga afër procesin e rinumërimit të votave në QNR.

Prokurori i Shtetit ka njoftuar publikun se në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR) tanimë janë të pranishëm Prokurori i Shtetit dhe hetuesit nga Policia e Kosovës, të cilët bashkërisht do t'i përcjellin dhe verifikojnë pretendimet e parashtruara nga KQZ-ja.

FLET PËR "EPOKËN E RE", SHPEND EMINI

# Rinumërimi nuk e dëmton proce

Drejtori i Institutit të Demokracisë për Zhvillim (D4D), Shpend Emini, ka bërë me dije se rinumërimi i qindra kutive të votimit nuk e dëmton procesin e zgjedhjeve të 6 tetorit. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se çdo dyshim rreth procesit zgjedhor duhet të vlerësohet dhe të rishikohet nga KQZ-ja. Sipas tij, organet përgjegjëse duhet të punojnë dhe veprojnë në ato raste kur vërtetohet manipulim ose kur komisionarët kanë ndërhyrë në mënyrë të jashtëligjshme në fletëvotim apo në formular. Emini ka treguar se për t'u ikur manipulimeve të mundshme nga komisionarët, numërimi i votave duhet të centralizohet



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

**Prishtinë, 17 tetor** - Drejtori i Institutit të Demokracisë për Zhvillim (D4D), Shpend Emini, e ka vlerësuar të drejtë vendimin e KQZ-së për rinumërim edhe të 530 vendvotimeve. Ai ka bërë me dije se çdo dyshim rreth procesit zgjedhor duhet të vlerësohet dhe të rishikohet nga KQZ-ja.

Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Emini ka thënë se rinumërimi i votave nuk e dëmton procesin zgjedhor. "Ajo çka është e rëndësishme është se duhet të bëhet dallimi mes rinumërimit dhe tentimit të ndryshimit apo manipulimit gjatë numërimit të fletëvotimeve. Rinumërimi nuk e dëmton procesin zgjedhor pasi ka të bëjë me verifikimin e fletëvotimeve pas dyshimeve të ngritura. Organet përgjegjëse për drejtësinë zgjedhore duhet të punojnë dhe veprojnë në ato raste ku vërtetohet manipulimi, pra në rastet kur komisionarët kanë ndërhyrë në mënyrë të jashtëligjshëm në fletëvotim apo në formularë të tjerë", ka thënë Emini.

Ai ka deklaruar se u takon institucioneve për menaxhimin e zgjedhjeve të vlerësojnë nëse ka bazë për rinumërim të përgjithshëm në nivel vendi, e jo partitive politike. "Partive politike u takon të ankohen nëse kanë prova se procesi është dëmtuar dhe ka ndikim direkt në rezultate. Nuk duhet të ketë vonesa të paarsyeshme të përmbylljes së procesit. Krahasuar me zgjedhjet e viteve të kaluara, ka një përmirësim të dukshëm të punës nga ana e KQZ-së dhe institucioneve të tjera, andaj rinumërimi mund të ndodhë vetëm atëherë kur ka prova dhe bazë të fortë për t'i rinumëruar të gjitha vendvotimet", është shprehur ai.

Emini ka folur edhe për ankesat e kandidatëve për deputetë ndaj komisionarëve partiakë për bartje të votave te kandidatët e tjerë. Ai ka deklaruar se në rast se vërtetohet se ka pasur vjedhje të votave për t'i ndryshuar rezultatet për një kandidat të caktuar brenda subjekteve politike, iu takon organeve të drejtësisë të ndërmarrin masa të parapara në kodin penal. Emini ka treguar se për t'i ikur këtij fenomeni duhet të ndodhë centralizimi i numërimit të votave. "Në lidhje me parregullsitë e shkaktuara gjatë numërimit, si organizatë (D4D) në vitin 2013 patëm rekomanduar që çështja e numërimit të centralizohet, pra që kutitë të mos hapen në vendvotime, por ato të barten, për shembull, në QNR dhe numërimi të bëhet aty, për t'u ikur parregullsive të mundshme, e sidomos manipulimeve të mundshme nga ana e komisionarëve", ka thënë Emini.

**"Epoka e re":** *Z. Emini, KQZ-ja ka marrë vendim për rinumërim edhe të 530 vendvotimeve, derisa më herët janë rinumëruar edhe mbi 300 kuti të tjera. Si e keni parë këtë vendim të KQZ-së?*

Emini: Vendimi i KQZ-së është bazuar pas kërkesës së QNR-së për rinumërim për shkak të mospërputhjeve në formular. Çdo dyshim duhet të vlerësohet dhe të rishikohet nga KQZ-ja, andaj edhe ky vendim është i duhur pasi ka të bëjë me një proces që ndërlidhet me integritetin zgjedhor. Në rast se ka mospërputhje në formular në ato vendvotime që rinumërohen, prokuroria duhet të ndërmarrë masa në përputhje me ligjet në fuqi në mënyrë që të parandalohen aktet e tilla në proceset e ardhshme.

**"Epoka e re":** *Rinumërimet e pjesshme kanë shtuar zërat se me këto veprime po tentohet të prishet procesi zgjedhor. A po lëndohet ky proces me veprime të tilla?*

**Emini:** Çdo dyshim mbi manipulim të mundshëm dëmton procesin zgjedhor dhe besimin e qytetarëve në këtë proces. Ajo çka është e rëndësishme është se duhet të bëhet dallimi mes rinumërimit dhe tentimit të ndryshimit apo manipulimit gjatë numërimit të fletëvotimeve. Rinumërimi nuk e dëmton procesin zgjedhor pasi ka të bëjë me verifikimin e fletëvotimeve pas dyshimeve të ngritura. Organet përgjegjëse për drejtësinë zgjedhore duhet të punojnë dhe veprojnë në ato raste ku vërtetohet manipulimi, pra në rastet kur komisionarët kanë ndërhyrë në mënyrë të jashtëligjshëm në fletëvotim apo në formularë të tjerë.

**"Epoka e re":** *Pas përfundimit të zgjedhjeve kemi pasur kërkesa të LDK-së, të PDK-së dhe të koalicionit Nisma-AKR-PD për rinumërim të votave në nivel vendi. Arsyetimet e tyre kanë qenë për disa gabime teknike në formularë. Sa janë të mjaftueshme këto arsye për të ndodhur rinumërimi i përgjithshëm?*

**Emini:** U takon institucioneve për menaxhimin e zgjedhjeve të vlerësojnë nëse ka bazë për rinumërim të përgjithshëm në nivel vendi, e jo vetëm pse atë e kërkojnë partitë. Partive politike u takon të ankohen nëse kanë prova se procesi është dëmtuar dhe ka ndikim në rezultate. Nuk duhet të ketë vonesa të paarsyeshme të përmbylljes së procesit. Krahasuar me

# sin zgjedhor



zgjedhjet e viteve të kaluara, ka një përmirësim të dukshëm të punës nga ana e KQZ-së dhe institucioneve të tjera, andaj rinumërimi mund të ndodhë vetëm kur ka prova dhe bazë të fortë për t'i rinumëruar të gjitha vendvotimet.

**"Epoka e re":** *Si asnjëherë më parë kemi pasur pretendime të kandidatëve për deputetë se u janë vjedhur votat nga komisionarët partiakë. Nëse këto pretendime vërtetohen, kush duhet të përgjigjet?*

**Emini:** Në rast se vërtetohet se ka pasur vjedhje të votave për t'i ndryshuar rezultatet për një kandidat të caktuar brenda subjekteve politike, u takon organeve të drejtësisë të ndërmarrin masa të parapara në kodin penal. Institucionet për drejtësinë zgjedhore, Prokuroria a Shtetit, Policia e Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe ato për administrimin e zgjedhjeve KQZ dhe PZAP në vitin 2016 kanë nënshkruar Memorandum Bashkëpunimi, i cili ka për qëllim ngritjen e nivelit të bashkëpunimit mes këtyre institucioneve, parandalimin e shkeljeve ligjore, hetimin, ndjekjen dhe gjykimin efikas të të gjitha rasteve që bien ndesh me ligjet, rregullat zgjedhore apo veprat penale kundër të drejtave të votimit në të gjitha fazat e procesit zgjedhor. Veprimet e prokurorisë në zgjedhjet e kaluara kanë qenë të shpejta, ku është ngritur aktakuzë ndaj personave që kanë kryer vepra penale nga të cilat për disa kanë rezultuar me aktgjykimin fajësues. Presim që prokuroria, por edhe institucionet e tjera të veprojnë njëjtë në rastet kur vërtetohet që komisionarë të caktuar kanë ndikuar në ndryshim të rezultateve për kandidatë të caktuar dhe të hetohet nëse edhe kandidatët kanë shtyrë komisionarët që të manipulojnë në përfitim të tyre.

**"Epoka e re":** *Këto probleme me të cilat po përballet Kosova në çdo palë zgjedhje a do të mund t'i eliminonte një reformë e mirëfilltë zgjedhore?*

**Emini:** Reforma zgjedhore përmendet pas çdo procesi zgjedhor, pasi disa prej parregullsive janë përsëritur që nga viti 2010, kur ka qenë edhe hera e fundit që është punuar në reformë, pa marrë parasysh fillimin e punës në reformë gjatë këtij viti i cili u ndërpre për shkak të shpërndarjes së Kuvendit. Një reformë e cila do t'i prekë jo vetëm çështjet teknike, por edhe ato përmbajtjesore, mund t'i eliminojë parregullsitë të cilat mund të ndikojnë në humbjen e besimit në procesin zgjedhor. Në lidhje me parregullsitë e shkaktuara gjatë numërimit, si organizatë (D4D) në vitin 2013 patëm rekomanduar që çështja e numërimit të centralizohet, pra që kutitë të mos hapen në vendvotime, por ato të barten, për shembull, në QNR dhe numërimi të bëhet aty, për t'u ikur parregullsive të mundshme, e sidomos manipulimeve të mundshme nga ana e komisionarëve.




# LV-ja ankohet në PZAP: Të numërohen të gjitha fletëvotimet e mërgatës

**Prishtinë, 17 tetor (ER)** - Lëvizja Vetëvendosje (LV) të enjten ka ushtruar ankesë në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP) lidhur me mosnumërimin në Qendrën e Numërimit të Rezultateve të 4 639 dërgesave postare me fletëvotime të ardhura nga mërgata. "Mbrëmë u numëruan 13 491 fletëvotime të votuesve nga mërgata. Presim që PZAP të marrë vendim brenda afateve ligjore dhe ta urdhërojë KQZ-në, shërbimin për votimin jashtë vendit, që pa vonesë t'i procedojë për numërim të gjitha fletëvotimet e ardhura nga mërgata jonë. Arsyetimet procedurale që artificialisht po i mbivendosen vullnetit të lirë të zgjedhësve nga mërgata e cenojnë demokracinë. Andaj ato fletëvotime duhet të numërohen", është thënë në njoftimin e LV-së.



# Akreditohet Qendra për Studime Universitare e FSK-së

**Prishtinë, 17 tetor (ER)** - Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (KD i AKK-së) ka nxjerrë vendim me rastin e procesit të validimit dhe akreditimit të Qendrës për Studime Universitare të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK).
KD i AKK-së në vendimin e lëshuar ka njoftuar se validohet dhe akreditohet Qendra për Studime Universitare e Forcës së Sigurisë së Kosovës (QSU), me adresë Kazerma "Adem Jashari" në Prishtinë, për periudhën trevjeçare me kualifikimin "Nëntoger në Forcat e Armatosura, Niveli V sipas KKK me 120 kredi të AAP".
Forca e Sigurisë e Kosovës në kuadër të mandatit të ri për ngritjen e kapaciteteve profesionale të edukimit ushtarak ka rishikuar dhe zhvilluar planprogramin e QSU-së për fillimin e procesit të akreditimit bazuar në nenin 23, pika 6 e Ligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, andaj si rezultat i një pune profesionale të KDS-së dhe QSU-së, është marrë vendim mbi akreditimin e profesionit të ushtarakut nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (KD i AKK).

# Kosova, pjesëmarrëse në Forumin për forcimin e bashkëpunimit të sistemeve prokuroriale të shteteve ballkanike

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 17 TETOR - Në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit regjional të sistemeve prokuroriale në Izmir të Turqisë po mbahet Forumi i Parë i Punës së prokurorëve të përgjithshëm të shteteve ballkanike, në të cilin po merr pjesë një delegacion kosovar, i përbërë nga ushtruesi i detyrës së kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, Afrim Shefkiu dhe drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Lavdim Krasniqi, ku janë të pranishëm edhe shumë kryeprokurorë dhe prokurorë të sistemeve prokuroriale ballkanike.

Qëllimi i organizimit të këtij forumi është diskutimi i rëndësisë së fuqizimit të bashkëpunimit regjional të sistemeve prokuroriale, në mënyrë që të mbështetet hetimi dhe ndjekja penale e krimeve serioze dhe të karakterit ndërkufitar, pastaj të shtohen përpjekjet për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe profesionale përmes shkëmbimit të përvojave dhe rritjes së bashkëpunimit në fushën e drejtësisë në mes të vendeve ballkanike dhe më gjerë.

Delegacioni nga Kosova ka prezantuar në sesionet e këtij forumi ndërkombëtar në emër të Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe përgjithësisht të sistemit prokurorial shtetëror, duke vënë në pah synimet e së ardhmes për formimin e ekipeve të përbashkëta hetimore me përfaqësues të institucioneve të sundimit të ligjit të dy apo më shumë vendeve, përcaktimin e ekipeve për vepra penale specifike në bazë të marrëveshjeve në mes të shteteve, anëtarësimin në organizata profesionale dhe nxjerrjen e protokolleve dhe marrëveshjeve në mes të shteteve, çështje këto që radhiten në mesin e sfidave kryesore të sistemit prokurorial jo vetëm kosovar.

Gjatë zhvillimit të punimeve të forumit do të miratohet një deklaratë e përbashkët e pjesëmarrësve, me anë të së cilës kërkohet një angazhim më i shtuar në raport me kërkesat drejtuar shteteve të ndryshme dhe organizimin e tryezave të tilla të punës me aktorë të institucioneve të sundimit të ligjit të shteteve regjionale, të cilat ndihmojnë tejkalimin e sfidave të ndërsjella.






# Policia konfiskon armë dhe municion në Gjakovë

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Pas një pune operativo-hetimore Njësia e Hetimeve të Drejtorisë Rajonale të Policisë Kufitare 'Perëndimi' në Gjakovë, në bashkëpunim me njësitë e tjera të Drejtorisë Rajonale në Gjakovë, kanë realizuar një operacion policor. Sipas njoftimit të policisë, plani operativ "ARMËT" është kryer në fshatin Fshej të Gjakovës, me ç'rast gjatë bastisjes janë konfiskuar sasi e konsiderueshme e armëve dhe municionit dhe mjete të tjera të ftohta si dy AK 47, një revole, 290 fishekë të kalibrave të ndryshëm, shtatë karikatorë të armëve AK-47, katër copë krehër të fishekëve, një pastrues të armëve, dy shufra metalike, tri thika ushtarake dhe një boks të hekurt. Ky operacion policor është realizuar në bazë të urdhërkontrollit të lëshuar nga Prokuroria Themelore në Gjakovë. Policia e Kosovës mbetet e përkushtuar për zbulimin dhe parandalimin e dukurive negative, përfshirë edhe parandalimin e posedimit të armëve ilegale.

## Teatri i Gjilanit shpall konkurs për dizajnimin e logos së re

GJILAN, 17 TETOR (ER) - Teatri i Qytetit të Gjilanit ka shpallur konkurs për dizajnimin e logos së re, duke i ftuar të gjithë disenjatorët që të aplikojnë me punimet e tyre për logon e re të këtij institucioni kulturor.

Drejtori i Teatrit të Qytetit, Erson Zymberi, ka deklaruar se duhet të marrin parasysh se punimet e tyre duhet të kenë elemente artistike dhe estetike të dallueshme për veprimtarinë e teatrit, të jetë origjinale dhe unike, si dhe elemente të tjera. "Përpos ndryshimeve të mëdha, që prej kalendarit kulturor e deri te brendingu, kemi vendosur që Teatrit të Qytetit të Gjilanit t'i japim pamje tjetër edhe përmes logos. Të gjithë disenjatorët janë të lirë që me punimet e tyre të aplikojnë përmes konkursit publik. Komisioni profesional do ta zgjedhë logon më të mirë dhe ky institucion i krenarisë do ta ketë shenjën e veçantë dalluese", ka deklaruar Zymberi.

Konkursi është shpallur të hënën do të jetë i hapur 15 ditë.



# Kontesha e Wessexit bën thirrje për akomodimin e viktimave të dhunës seksuale



PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të enjten Lartmadhërinë e saj, Konteshën Sophie të Wessex, me të cilën ka biseduar për të arriturat dhe për sfidat në ballafaqimin me të kaluarën, veçanërisht kur janë në pyetje viktimat e dhunës seksuale.
Presidenti Thaçi falënderoi për vizitën dhe angazhimin e Konteshës së Wessexit, por edhe të Britanisë së Madhe në përgjithësi. "Jemi mirënjohës për mbështetjen e përgjithshme të Britanisë së Madhe, veçanërisht për punën dhe angazhimin në ballafaqimin me plagët si kjo e viktimave të dhunës seksuale në luftë", u shpreh presidenti Thaçi. "Pjesëmarrja juaj, mesazhet tuaja, janë inkurajim për viktimat dhe për tërë shoqërinë", u shpreh presidenti Thaçi.
Lartmadhëria e saj, Kontesha e Wessexit, u shpreh se është e rëndësishme që viktimat ta marrin kujdesin, vëmendjen dhe përkrahjen e duhur.
Presidenti Thaçi dhe Kontesha e Wessexit u pajtuan se është përgjegjësi e të gjitha segmenteve të shoqërisë që të bëjnë sa më shumë për akomodimin e të gjitha viktimave të luftës, në veçanti të viktimave të dhunës seksuale.

# Kandidatja për deputete, Selvije Halimi, kërkon që të ketë rinumërim të votave një nga një

EPOKA E RE Faton DËRMAKU



PRISHTINË, 17 TETOR - Kandidatja për deputete e Partisë Demokratike të Kosovës, Selvije Halimi, nëpërmjet një shkrimi të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook", me titull "Heshtja në raport me zgjedhjet dhe të zgjedhurit në Kosovë", ka kërkuar që të ketë rinumërim të votave një nga një. Këtë qëndrim ajo e bazon në reagimet e kandidatëve të të gjitha subjekteve për manipulim të votave gjatë numërimit në vendvotime të cilat edhe po argumentohen. "Më 6 tetor 2019 qytetarët e Kosovës u detyruan ta japin verdiktin e vet për t'i zgjedhur deputetët e Kuvendit të Kosovës. E quaj detyrim për faktin e papërgjegjshmërisë së njerëzve që kërkojnë përgjegjësi dhe s'mund t'i bartin ato dhe u dashtë të shkohet në zgjedhje të parakohshme. Tani kemi një rezultat zgjedhor preliminar të subjekteve politike dhe po vazhdon numërimi i votave për kandidatët për deputetë. Ajo që po më shqetëson më së tepërmi është fakti se kemi reagime të kandidatëve të të gjitha subjekteve për manipulim të votave gjatë numërimit në vendvotime (të cilat edhe po argumentohen) dhe kemi heshtje për këtë fakt. Kjo heshtje dhe mosveprimi që të vërtetohen shqetësimet e ngritura dhe të lejohet përbërje joreale e Kuvendit, qoftë edhe në renditje, lë për të dëshiruar për demokracinë në Kosove dhe të drejtën kushtetuese të qytetarëve për të zgjedhur", ka thënë Halimi, duke shtuar se edhe vetë KQZ-ja e pranoi faktin e manipulimit. "KQZ-ja është për çdo lëvdatë për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, por mendoj që në këtë rast duhet të ndërmarrë veprime si: rinumërim të votave një nga një si dhe në çdo kuti ku vërtetohet manipulim i votave përgjegjësit (komisionarë e vëzhgues të përgjigjen sipas ligjit). Vetëm një veprim i tillë do të ishte një hap i drejtë për ta garantuar të drejtën kushtetuese qytetare për të zgjedhur si dhe hap i madh për parandalimin e të zgjedhurve në mënyrë jokorrekte", ka thënë ajo.
Kandidatja për deputete, Selvije Halimi, ka thënë se e befason fakti i heshtjes së subjekteve politike (përveç PDK-së, që ka kërkuar numërim të votave një nga një), heshtja e vëzhguesve nga shoqëria civile, madje heshtja edhe e Gjykatës Kushtetuese, e cila duhet të ndërmarrë veprime kur cenohet e drejta qytetare për të zgjedhur e garantuar me Kushtetutë. "Kjo heshtje, për ta zbardhur të vërtetën dhe për t'i bërë krenarë të gjithë të zgjedhurit si dhe qytetarët, se besimi i tyre i shprehur me votë po mbrohet nga institucionet, është e papranueshme! Andaj, veproni e mos heshtni! Mos u bëni bashkëfajtorë në këtë proces!", ka deklaruar zyrtarja e PDK-së, Selvije Halimi.

## Kadri Kastrati ftohet për intervistim nga Gjykata Speciale



PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Ish-komandanti i Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK), Kadri Kastrati, është ftuar nga Gjykata Speciale. "Për hir të informimit të drejtë ju njoftoj se kam pranuar ftesë për intervistim nga Gjykata Speciale në Hagë. Ky intervistim do të bëhet në javën e parë të muajit nëntor. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë e drejtë dhe e shenjtë dhe do të mbetet e tillë. Edhe në këtë rast do të dalim faqebardhë!", ka shkruar Kastrati në llogarinë e vet në "Facebook".

# Komuna e Prizrenit punëson pesë persona me nevoja të veçanta

PRIZREN, 17 TETOR (ER) - Komuna e Prizrenit, në kuadër të fushatës së muajit tetor, si muaj i mundësive të barabarta, ka angazhuar me kontratë të përkohshme në institucionet e ndryshme komunale persona me nevoja të veçanta.
Nëpërmjet Drejtorisë së Administratës, si dhe Njësisë për të Drejtat e Njeriut dhe Barazisë Gjinore, janë punësuar pesë persona me nevoja të veçanta, duke përshirë dy në sektorin e Ofiqarisë, dy në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe një në Qendrën për Punë Sociale, ndërkaq angazhimi i tyre do të jetë për një kohëzgjatje prej tre muajve.
Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë së Administratës, Osman Hajdari, ka thënë se Komuna e Prizrenit nga viti i ardhshëm do të synojë rritjen edhe të numrit të punëtorëve të rregullt nga kategoria e personave me nevoja të veçanta. "Komuna e Prizrenit aktualisht ka të punësuar tre persona me kontratë të rregullt nga kategoria e personave me nevoja të veçanta. Lidhur me këtë ekziston vullneti i kryetarit që nga viti i ardhshëm ta rrisim këtë numër. Për këtë qëllim do të veprojmë në përputhshmëri me ligjet në fuqi dhe do të synojmë t'i krijojmë hapësirat e nevojshme financiare", ka thënë Hajdari.



# Po vazhdojnë punimet për ndërtimin e objektit të shkollës në Malishevë



"Ndërtimi i një shkolle të re brenda qytetit ka qenë tepër i nevojshëm, pasi qyteti aktualisht ka vetëm një shkollë të ciklit fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa numri i nxënësve është shumë i madh e, po ashtu, edhe largësia e madhe për disa nga lagjet e qytetit", ka thënë Begaj.

MALISHEVË, 17 TETOR (ER) - Në qytetin e Malishevës kanë filluar dhe po vazhdojnë punimet për ndërtimin e një objekti të ri shkollor i cili do të jetë një prej objekteve më të mëdha shkollore të nivelit të shkollimit fillor dhe të mesëm të ulët. Punimet në këtë objekt të ri shkollor i kanë parë nga afër kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, drejtori i Drejtorisë për Arsim dhe Edukim, Blerim Thaçi dhe drejtori i Drejtorisë së Administratës, Hajrullah Mazreku.
Këta u njoftuan nga operatori me ecurinë e punimeve të deritanishme, punime të cilat janë duke vazhduar sipas dinamikës së paraparë, ndërsa punimet për ndërtimin e objektit janë duke u bërë sipas standardeve më të larta të ndërtimit. "Ndërtimi i një shkolle të re brenda qytetit ka qenë tepër i nevojshëm, pasi qyteti aktualisht ka vetëm një shkollë të ciklit fillor dhe të mesëm të ulët, ndërsa numri i nxënësve është shumë i madh e, po ashtu, edhe largësia e madhe për disa nga lagjet e qytetit. Kjo shkollë ka qenë kërkesë e vazhdueshme e banorëve të pjesës më të madhe të qytetit", ka thënë Begaj.
Ky objekt shkollor, që është duke u ndërtuar e që pritet të përfundojë në vitin 2020, është një prej objekteve më të mëdha dhe më moderne shkollore në Komunën e Malishevës, i përcjellë me të gjithë infrastrukturën e nevojshme, përfshirë ambientin e brendshëm dhe të jashtëm. Ndërtimi i këtij objekti shkollor, mundësohet nga Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë dhe do të kushtojë rreth 2.2 milionë euro.

# 1 100 fermerë subvencionohen nga Komuna e Prizrenit me farë gruri

PRIZREN, 17 TETOR (ER) - Drejtoria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Prizrenit të enjten ka bërë shpërndarjen e farës së grurit për fermerët përfitues nga thirrja publike e kësaj drejtorie, ku pjesëmarrës ishin edhe nënkryetari i Komunës së Prizrenit, Eshref Memaj dhe drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Egzon Elshani.
Përfitues nga ky projekt janë 1 100 fermerë, ndërkaq sasia e farës me të cilën u furnizua secili fermer është 225 kilogramë. Me sasinë e përgjithshme të farës që është shpërndarë do të mundësohet mbjellja e një sipërfaqeje prej 950 hektarësh.
Fara e grurit, e cila u shpërnda për përfituesit, është e kualitetit të lartë dhe i plotëson të gjitha kushtet optimale për mbjellje. Kostoja e këtij projekti është 115,958.5 mijë euro dhe të gjithë aplikuesit të cilët kanë poseduar dokumentet e nevojshme dhe i kanë plotësuar kushtet kanë përfituar nga ky subvencion.





## Nisin dy rrugë të reja në fshatin Kushavec të Gjakovës

GJAKOVË, 17 TETOR (ER) - Peizazhi i bukur i fshatit Kushavec në Komunën e Gjakovës do të jetë më lehtë i qasshëm tani që ka filluar asfaltimi i rrugës për te Kodra Kuzhnini dhe rruga "Liza Vorfi".
Kryetari i komunës, Ardian Gjini, u shpreh që vëllimi i punëve për realizimin e projekteve është i madh dhe se moti i mirë i këtyre ditëve lejon që të finalizohen projektet, punimet e të cilave janë shtyrë deri në këtë periudhë për shkak të konotacionit që mund të kishte nëse fillonin gjatë fushatës elektorale.
Këto dy rrugë në tërësi kanë gjatësi 800 metra dhe kostoja e tyre është mbi 60 000 euro.

# Guvernatori Mehmeti takoi zyrtarët e Thesarit Amerikan dhe ata të FMN-së

PRISHTINË, 17 TETOR (ER) - Delegacioni i Bankës Qendrore i Kosovës (BQK), i udhëhequr nga guvernatori Fehmi Mehmeti, gjatë pjesëmarrjes në takimet vjeshtore të Fondit Monetar Ndërkombëtar dhe të Bankës Botërore që po zhvillohen në Uashington, ka takuar përfaqësues të Thesarit Amerikan, të udhëhequr nga William C. Thomas, të cilin e ka informuar lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe me treguesit e shëndetit financiar. Guvernatori Mehmeti ka shprehur falënderimin dhe mirënjohjen për kontributin e madh që Thesari Amerikan ka dhënë për zhvillimin e kapaciteteve të BQK-së dhe për përkrahjen e vazhdueshme përmes asistencave teknike si dhe përkrahjes për zhvillimin e sektorit financiar të Kosovës.
Ndërkaq William C. Thomas ka përgëzuar guvernatorin Mehmeti për të arriturat në sektorin financiar si dhe ka konfirmuar përkrahjen e mëtejme për BQK-në nga ana e Thesarit Amerikan. "Guvernatori Mehmeti, po ashtu, ka zhvilluar takim me ekipin e misionit të FMN-së për Kosovë, i udhëhequr nga shefi i ri i Misionit, Gabriel Di Bella, me ç'rast e informoi lidhur me zhvillimet e fundit në sektorin financiar dhe treguesit kryesorë të shëndetit financiar. Po ashtu, guvernatori Mehmeti ka falënderuar përfaqësuesin e FMN-së lidhur me raportin e Rishikimit të Stabilitetit të Sektorit Financiar (Financial Stability Sector Review) duke shprehur përkushtimin e BQK-së për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga ky raport.
Delegacioni i BQK-së do të zhvillojë takime me përfaqësues të lartë të FMN-së dhe Bankës Botërore edhe gjatë ditëve të ardhshme.



# 'Auto Mita' dhe 'Galvazing' certifikohen si operatorë ekonomikë të autorizuar




EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 17 TETOR - Drejtori i Doganës së Kosovës, Bahri Berisha, ka ndarë certifikatat për dy kompanitë kosovare "Auto Mita" dhe "Galvazing" të certifikuara si Operator Ekonomik i Autorizuar (OEA). Me këtë rast, Berisha ka deklaruar se Kosova është ndër vendet e para në rajon që ka autorizuar bizneset me standarde evropiane. Sipas tij, kompanitë e verifikuara do të kenë lehtësira tregtare dhe zhdoganim. "Në emër të Doganës shpreh falënderim për Bankën Botërore dhe GIZ-in gjerman. Jemi shumë të lumtur që kemi dy kompanitë e para që po autorizohen me koncept evropian dhe botëror. Institucionet e Kosovës kanë arritur të kenë standarde të larta evropiane, por edhe bizneset", ka thënë Berisha, duke shtuar se në aspektin regjional nuk ka shumë kompani që i kanë përmbushur këto standarde dhe të cilat kanë marrë këtë status andaj, sipas tij, Kosova është ndër vendet e para. "Dogana u jep lehtësira maksimale bizneseve. Shpresojmë të vazhdojmë edhe me kompanitë e tjera", ka thënë Berisha.
Kurse koordinatori i projektit, Ibrahim Xhakaj, ka thënë se kompanitë, përveç lehtësirave doganore, do të kenë edhe përfitime të tjera. "Dogana e Kosovës ka kompletuar bazën ligjoren për operatorë ekonomikë. Programi është në funksion dhe jemi në përgatitje të certifikatave të tjera. Dogana e Kosovës po bashkëpunon me Bankën Botërore dhe hyn në kuadër të lehtësirave tregtare. Këto kompani tani janë në partneritet të ngushtë me Doganën dhe do të mund t'i shfrytëzojnë lehtësirat tregtare doganore dhe zhdoganim. Ne do të vazhdojmë edhe më tutje, përveç përfitimeve doganore, do të kemi edhe përfitime të tjera", u shpreh ai.
Përfaqësuesja e Bankës Botërore, Mimoza Miftari, ka thënë se kompanive do t'u zvogëlohet koha dhe kostoja gjatë procesit të importit dhe eksportit. "Grupi i Bankës Botërore ka pasur bashkëpunim të shkëlqyeshëm qysh nga viti 2017. Programi për lehtësirat e tregtisë mbështet vendet për t'i përmbushur obligimet që janë në marrëveshje. Duke zvogëluar kohën dhe koston në procesin e eksportit dhe importit", ka thënë ajo.




Ndërkaq përfaqësuesja e GIZ-it gjerman, Tanja Boshkovic, ka thënë se do të vazhdojnë edhe me tutje të mbështesin projekte të tilla. "Ju falënderoj të gjithëve dhe ju përgëzoj për punën. Falënderoj Kosovën për punën e bërë deri më tani. Ne jemi të gatshëm të insistojmë edhe më tutje. Ne do të jemi të hapur në çdo kohë për t'i përkrahur iniciativat tuaja. Do të vazhdojmë edhe në të ardhmen për bashkëpunimet tona. Urime për projektin", u shpreh ajo.
Zgjim Mita nga kompania "Auto Mita" ka thënë se mbesin partner shembull për Doganën dhe shtetin e Kosovës. Kurse Petrit Shala nga kompania "Galvazing" ka deklaruar se ndihen të privilegjuar, duke theksuar se tani kompania do të jetë më fleksibile.

Një vështrim për romanin e fundit të Ismail Kadaresë / (Rreth çmimit Nobel brenda dhe jashtë tij)

# KUR SUNDUESIT



Shkëlzen UKËHAXHAJ

Këto ditë pata kënaqësinë ta lexoj me ëndje një vepër të vërtetë arti. Më në fund thashë se letërsia qenka akoma e pranishme në jetën tonë sepse politika ditore na ka verbuar dhe po konsumon trurin tonë, i cili nuk jeton më shumë se një jetë njeriu.

Roman i jashtëzakonshëm nga shkrimtari ynë i jashtëzakonshëm: "Kur sunduesit grinden", ky është titulli i romanit. Një bisedë misterioze telefonike vetëm treminutëshe midis Stalinit dhe poetit të famshëm rus Pasternak.

Nuk është hera e parë që shkrimtari ynë, Ismail Kadare, të matet me majat e politikës botërore në art. Gjithmonë i suksesshëm, i veçantë, ndoshta nga më të veçantit që njeh letërsia moderne në shkallë globale.

Tashmë është e njohur që shkrimtari ynë i madh e ka sens të tij prej krijuesi që, pasi përcakton projektin e monumentit të tij krijues, merr një temë të madhe e atë pastaj e imtëson gjatë analizës pafundësisht, duke e zgjeruar deri në kufijtë e gjithënjerëzores. Po ashtu, në të kundërtën e kësaj ai niset nga një moment thuaj se i përditshmërisë së zakonshme dhe me fuqinë e mendjes së tij krijuese arrin ta zgjerojë, siç thamë, deri te mbarënjerëzorja në pafundësinë e kufijve të saj. Që ta bëjë këtë të zakonshme të jashtëzakonshme, mendoj unë, e ndihmon intuita shumë e thellë, muza poetike që fshihet brenda tij. Edhe durimi krijues është një cilësi e shkrimtarëve të mëdhenj, e Kadare e ka më tepër se të mjaftueshëm. Mbi të gjitha, për krijimin e një letërsie të tillë nevojitet një njohje e thellë për epokat dhe periudhat e ndryshme të historisë deri te antikiteti i thellë. Kadare për këto tema ka dëshmuar se ka njohuri të shumta dhe i ka kthyer në monumente letrare në kohën tonë moderne.

Kadare temë të romanit të tij e bën një bisedë telefonike treminutëshe midis Stalinit, numrit një të Bashkimit Sovjetik dhe shkrimtarit të shquar Sovjetik, të Rusisë së sotme. Kjo bisedë misterioze telefonike bëhet pas arrestimit të poetit, po ashtu të shquar rus Osip Mandelshtami që, ky i fundit, paska shkruar një vjershë politike kundër Stalinit. Ndër të tjera, Stalinin e quan Maloku i Gjeorgjisë. Poezia nuk është botuar asnjëherë, por autori e ka lexuar nëpër rrethe miqsh. Me siguri në atë rreth ka pasur të përfshirë edhe spiunë që kanë kryer detyrën për pushtetin e "Malokut" gjeorgjian. Kjo është e kuptueshme edhe për mua, e për autorin tonë, Kadarenë, me siguri edhe e përjetuar. Pasi që aludimi i bërë midis Shqipërisë dhe Rusisë lë për t'u kuptuar lehtë kjo gjë.

Për të na ofruar tablonë e jetës së shoqërisë së asaj kohe, nën një shtet diktatorial të dorës së hekurt, sidomos gjendjen shpirtërore të krijuesve, në veçanti të artit letrar, Kadare përmes atyre tre minutave të telefonatës misterioze: stalin - Pasternak dhe trembëdhjetë versioneve, ka arritur që jo vetëm gjeneratës sime, por shumë e shumë gjeneratave që vijnë pas nesh ua ka dhënë mundësinë që ta përjetojnë këtë kohë përmes artit kadarean, ashtu siç ne sot përjetojmë poemat homerike, apo jetën e Greqisë antike përmes tragjedive të Eskilit me shokë. Këto trembëdhjetë versionet e atyre 3-4 minutave të shprehura përmes dëshmitarëve okularë dhe jookularë, ndonjëri prej tyre edhe studiues i këtyre shkrimtarëve disidentë rusë, kanë krijuar efektin e besimit të vërtetësisë historike të romanit. Version pas versioni, kontradiktat midis të vërtetës së versionit paraprak, lexuesin e fusin në malin e erudicionit të shkrimtarit tonë.

Romani ka një fillim shumë të pëlqyeshëm. Një student i Institutit Gorki dëshiron të shkojë në Sheshin Pushkin për ta vizituar shtatoren e këtij vigani të poezisë klasike ruse. Dhe me ato dy radhët e shkruara nga poeti, me shumëkuptimësinë dhe të mbështjellë me vellon e një misticizmi, mbi të gjitha edhe përkthimi pothuajse i pamundur i saktë, e detyron lexuesin t'i hapë sytë dhe të kërkojë në thellësi të këtyre faqeve. Vargjet: Një monument të gdhendur jo duarsh i ngrita vetes. Ky ishte përkthimi i keq. Ndryshe do të jetë vargu: Një monument që ju më ngritët, siç nuk e desha. Me këtë fillim detyrohemi edhe ne, lexuesi pra, të hyjmë dhe të shëtisim në intuitën e Kadaresë. Përkundër fillimit me poetë dhe vizitues te shtatoreve poetësh, esenca e romanit, apo më mirë narracioni i mëtutjeshëm, na fut në jetën e ashpër plot frikë dhe pa siguri nën diktaturën staliniste. Këtë errësirë të egër do ta përjetojë lexuesi gjithnjë e më shumë deri në faqet e fundit. Ky roman përcillet me shumë kulme, megjithatë një nga ato kulme të bukura është edhe përshkrimi i poezisë së Pushkinit kundër Carit. Tërë vepra përshkohet me porosinë e luftës midis më të mëdhenjve shkrimtarë në njërën anë dhe perandorëve, mbretërve, carëve apo edhe diktatorëve në anën tjetër.

Krahasimin që Kadare e bën midis poetëve rusë Mandelshtam - Pasternak, të cilët jetojnë në vitet e tridhjeta të shekullit të kaluar dhe dy poetëve tanë të shquar Noli e Lasgushi, të cilët, po ashtu, jetojnë në vitet e të njëjtit shekull, është një tjetër kulm i bukur i romanit. Kadare pretendon se jeta e dy shkrimtarëve rusë nën "mbretërinë" e diktatorit Stalini dhe dy poetëve shqiptarë, të cilët e përjetuan diktaturën e përçudnuar të mbretit Zog, mund të krahasohet. Mendoj se krahasimi çalon për shkak se Noli ynë e kishte luftuar Zogun me armë dhe e kishte rrëzuar nga froni, e më vonë nga arratia edhe me pendën e tij të artë. Ndërkohë Mondelshtami kishte kritikuar Stalinin, por vetëm me poezi dhe, sipas autorit tonë, me poezi të dobëta artistikisht. Nuk e kam kuptuar Kadarenë, pse nuk e ka marrë si shembull krahasimi për Pasternakun, poetin e tij, po ashtu të preferuar, Migjenin. Ndoshta edhe këtu, mendoj, është një çalim i vogël kadarean. Një arsye mund të jetë që Migjeni, apo poezia e tij i kishte shkuar përshtati sistemit komunist në Shqipëri. E vërtetë kjo, por edhe Lasgushi, ndonëse i injoruar, por i padënuar e, mbi të gjitha, Noli ynë po ashtu kishte privilegjet e tij, krijimtaria e të cilit ishte plotësisht e pacenuar dhe e pacensuruar.

Nëpërmjet këtyre trembëdhjetë versioneve të asaj telefonate të famshme, tanimë të njohura në përgjithësi për lexuesin, Kadare na sjell pamjet shumë të rënda të paperceptueshme për kohën në të cilën jetojmë ne sot. Presioni psikik që bëhet nëpërmjet thashethemeve, i mbështjell me petkun e misticizmit, ishte një nga armët më perfide të atij sistemi famëkeq. Në këtë pikë e panjohura e së ardhmes sjell një pasiguri dhe frikë të brendshme të papërballueshme. Një jetë midis dyshimit, mosbesimit, frikës nga çdo rreth dhe çdo anë. Këto storie të jetës, të një jete që s'do të donim ta jetojmë, s'donte ta jetonte as poeti Mondelshtam, i cili do të hidhej nga dritarja për të bërë vetëvrasje, por për fatin e tij te "keq" shpëton. Ai detyrohet, pastaj, ta jetojë atë jetën e tij të internimit, jetë të cilën ai në asnjë mënyrë nuk e donte.

Një gjendje të tillë të vështirë e kemi gjetur edhe gjetkë në letërsinë tonë: Xhezairi i Gjikës dhe Danjolli i Sherkës në "Vdekja më vjen prej syve te tillë", këto dy personazhe të Rexhep Qosjes, pothuajse janë të përkryer, janë personifikim i një jete të tillë të tmerrshme te ne. Vetë Kadare është treguar mjeshtër i madh i skenarëve të tillë të pushteteve monstruoze, si te "Dosja H". Pra, autori ynë e ka lëvruar këtë temë dhe mendoj se qëndron më lart se autorë të tjerë shqiptarë e të huaj, pa pretenduar që t'i vëmë pikën mendimit tonë.

Një segment tjetër i veprës është përpjekja e Stalinit për t'i përçarë poetët. Me atë telefonatën e tij të tmerrshme e misterioze njëkohësisht arrin që poetin e madh, Pastërnak, ta fusë në kurth. Në versionin e tretë:... Ne shokët tanë nuk i linim në baltë... tha. Dhe e mbylli telefonin. Kjo mund të nënkuptonte ti je një shok i keq, një tradhtar, një... një... e çka mos një. Kështu ai i fut frikën në palcë Pasternakut, kur e pyet: Çfarë mendoni ju për Mandelshtamin... Në versionin e njëmbëdhjetë, në faqen 157: "Po të isha mik i Mandelshtamit, unë do të dija ta mbroja më mirë", kishte thënë Stalini dhe kishte mbyllur telefonin. Kjo ishte njëra pamje, pamja e frikshme. Kadare me mjeshtërinë e tij, pa pritur na qet në anën tjetër të hamendjes dhe dyshimit. Po sikur Stalini nuk donte ta burgoste poetin e famshëm?! Stalini ndoshta kërkonte ndihmën e Pasternakut që ky të ndikonte me autoritetin e tij dhe ta mbronte Mandelshtamin. Kështu Stalini do të dilte burrë me zemër të madhe që përkrah poetët e kombit edhe kur ata e kritikojnë atë; apo sikur Stalini të mos jetë fyer fare nga poezia e poetit, përkundrazi të jetë ndjerë krenar?! Të tilla pyetje janë të pafundme që Kadare i shtron nëpër roman, atëherë lexuesi detyrohet të shkojë edhe më tutje në thellësitë e intuitës kadareane. Jo vetëm në këtë rast, në veprën letrare që ne po vështrojmë, por, gjithmonë nëpër kohë shtetarët janë sulmuar nga poetët, janë vënë në pozita qesharake apo janë treguar si mizorë, jo inteligjent dhe jo vigjilent për të ardhmen e popujve. Mendoj, edhe nëse kjo mund të qëndrojë në shumë raste, në përgjithësi kjo bie ndesh me të vërtetat historike. Te romani "Kur sunduesit grinden" vërehet po kjo tentativë, si nga poetët rusë ashtu edhe nga poeti ynë. Kur bëhet fjalë për Stalinin, nuk besoj që qëndron mendimi se ai ishte i paditur, jo inteligjent, sharlatan apo malok. Këtë mendim e hedhin poshtë vitet e gjata te sundimit në njërin nga shtetet më të mëdha në botë, udhëheqja në LDB kundër paktit Nazifashist etj. E hedhin poshtë, gjithashtu edhe shumë teorikë që e kanë studiuar jetën dhe veprën e Stalinit. Mandej, zikzaket e Stalinit me telefonatën me Pasternakun, arsyet e mbështetura në pikëpyetje të shumta nëpër versionet e ndryshme me hamendësime të papritura për Pasternakun, tregojnë se ai ka qenë i vështirë për t'u kuptuar dhe kapur në mat, kjo i ka bërë kundërshtarët e tij shpesh herë të mundur, bile ndonjëherë edhe dinakun Çurçill.



Pasternaku kishte një dëshirë të flaktë për të biseduar me Stalinin rreth një teme të veçantë: për jetën dhe vdekjen. Një intelektual i shkallës së Pasternakut nuk do të kishte interes të diskutonte tema shumë të thella filozofike, si jeta dhe vdekja, me cilindo. Apriori dihet që dijetarët nga më të mëdhenjtë janë marrë me këtë temë të pafundme. Andaj ç'i duhej Stalini Pasternakut po qe ai një malok gjeorgjian?! Dihet mirëfilli se Stalini mund t'i ndalte thashethemet në qytetin moskovit pa ndonjë vështirësi. Autori ynë mendon që kjo i konvenonte shefit të madh. Kadare ngre pikëpyetjen se ai me këtë "armë" dhe të tjera të tilla i përdorte për ta përçarë klasën intelektuale, të cilët ishin armiqtë e tij. Këtë edhe e arriti, kur Pastërnak deklaronte se nuk e kishte pasur mik Mandelshtamin. Nga këtu fillon pasiguria dhe dyshimi për gjithçka dhe vazhdon pa ndërprerë...

Krahasimin midis Rusisë staliniste dhe Shqipërisë e bën mbi disa elemente karakterizuese. Së pari krahason udhëheqësit e shtetit Stalin-Hoxha të cilët janë tiranë, diktatorë autoritarë të egër; së dyti krahason shkrimtarët respektivisht poetët: Mandelshtam-Pasternak me Nolin dhe Poradecin. Pastaj frika dhe pasiguria e jetës, është po ajo, pothuajse identike, pa asnjë ndryshim. Një version krahasimi mjaft i bukur, i veçantë për nga stili, më duket mua, përshkrimi i gjendjes shpirtërore e poetit rus,

# GRINDEN




kur Stalini e thërret në telefon dhe i bën atë pyetjen e tmerrshme: çfarë mendoni ju për Mandelshtamin? Frika dhe gjendja shpirtërore kaotike e të cilit janë pothuaj të papërshkrueshme. Gjithashtu, poeti ynë, Kadare, e pranon një thirrje telefonike nga njëshi i Shqipërisë, E. Hoxha. Këtu kemi një gjendje krejtësisht tjetër emocionale, në kuptimin pozitiv të fjalës. Personalisht, si Stalini Pasternakun, Enver Hoxha e thërret Ismail Kadarenë për ta përgëzuar për poemën e tij të fundit. Ne nuk kuptojmë më shumë rreth asaj telefonate. Ne arrijmë ta kuptojmë vetëm gjendjen e tij emocionale i cili s'mund të thotë më shumë se veç tri herë: faleminderit... faleminderit... faleminderit...

Përderisa Pasternaku pas shuarjes së zërit nga ana tjetër e receptorit në mënyrë proteste nga Stalini: Ti je një shok i keq. Ne kemi ditur t'i mbrojmë shokët më mirë. Dhe heshtje nga ana tjetër. E kuptueshme apriori që, një e thënë nga Stalini, ti je një shok i keq, nënkuptonte humbje, deklasim të gjithanshëm. Ai tenton ta marrë Stalinin prapë në telefon, por kjo ishte e pamundur, sepse ai telefonon ishte krijuar për të kryer vetëm një telefonatë. Pasternaku dhe gjendja e tij shpirtërore nga këtu ishte deklasuese dhe e papërshkrueshme me fjalë.

Edhe në anën tjetër të Kontinentit, shumë vjet më vonë, në Shqipëri, gjendja shpirtërore e poetit tonë nuk ishte hiq më e mirë se e kolegut të tij. Ndoshta vetë poeti rus ishte shkaku i këtij shqetësimi për poetin tonë. Inspirimi i Kadaresë nga Pasternaku: Ai s'mund të jetë krejt indiferent kundrejt këtij personazhi historiko-letrar, duke e bërë atë pjesë të romanit të tij të famshëm, "Ura me tri harqe". Por kjo "trimni" autorit tonë i kushton net të tëra pa gjumë, shqetësime të paimagjinueshme shpirtërore. Përballja me nr. 1 të shtëpisë botuese, ku ai kishte synimin për botimin e romanit dhe, natyrisht, ajo ishte nga të paktat në tërë vendin, ishte shume e vështirë. Pyetjet e tij bëheshin me sensin e një hetuesi me shumë përvojë, andaj përgjigjet duhej të ishin, po ashtu, të vëmendshme, të kontrollohej gjendja shpirtërore konform momentit. Një çalim dhe çmimi ishte jo vetëm mosbotimi, e kjo ishte e keqja më e vogël, por internimi e të tjerat që do të përcillnin pas tij. Kjo frikë, ky shqetësim, do ta ndjekë autorin tonë edhe pas përgjigjes pozitive nga drejtori i shtëpisë botuese sepse, dihej, se në një shkallë më të lartë qëndronin "prokurorët" që e studionin çdo vepër letrare pas botimit. E po qe se "prokurorët" gjenin diçka infiltruese, atëherë edhe drejtori do ta pësonte përveç autorit. Domethënë, zinxhiri nuk shkëputej edhe shkurt.

Konstruksioni i veprës, i ndërtuar mbi trembëdhjetë versionet e telefonatës së famshme Stalin-Pasternak, i ka mundësuar autorit tonë që të ngërthejë edhe shumë tema e nëntema të tjera të cilat veprën e bëjnë mjaft të kënaqshme për ta lexuar. Sa të kënaqshme për ta lexuar, po aq të thellë në kuptimin filozofik për t'u menduar. Hamendjet dhe pikëpyetjet që ngre rreth Helenës së Trojës apo Helenës së Greqisë, apo kur ishte Helenë e Greqisë dhe kur Helenë e Trojës. Quhej Helena e Greqisë dhe kuptohej si mbretëresha e pabesisë, apo ishte Helena e Trojës dhe kuptohej mbretëresha besnike; pasi i kishte dhënë besën të dashurit, me të gjitha rreziqet që kishte përbrenda ky hap i rrezikshëm i cili mbet në kujtesën e njerëzimit për shekuj me radhë, ajo shkon me të dashurin e vet, princin e Trojës. Ishte Helena fatkeqësi në historinë e Trojës, apo ishte vetë Kali i Trojës, një kurth i ngritur nga grekët. Pyetje të tilla që kanë mbetur pa u vërtetuar përgjatë shekujve e bëjnë veprën mjaft atraktive për nga shija dhe shumë të thellë për nga shumësia e pyetjeve.

Mund të thellohemi thellë e më thellë nëper minierat e romanit, sepse këtë mundësi na ka dhuruar autori ynë i jashtëzakonshëm; shkrimtari i letërsisë shqipe dhe i asaj botërore, aq bukur dhe me stil interesant gërsheton epokat dhe njerëzit - antikitetin e Helenës me Beatriçen e Mesjetës e deri te poetja e kohës sonë, Anna Akhmatova.

Ai vë përballë mbretërit, carët, diktatorët nëpër shekuj e vite përballë të të mëdhenjve poetë, ndër të cilët këmbëkryq rri edhe vetë. Bile-bile ai vë përballë edhe vetë më të mëdhenjtë shkrimtarë të botës si Tolstoin kundër Shekspirit. Për një çast autori ynë më duket se harron qëllimin e veprës, porosinë esenciale të saj, luftën për zotërimin e vendit të parë midis poetëve dhe diktatorëve me paraardhës. Ai çuditet si Tolstoi nuk e njeh Shekspirin për shkrimtarin nga më të mëdhenjtë, bile e rendit poshtë te të rëndomtit. Nganjëherë Kadare edhe shkrimtarët i quan të pakompromis dhe thuaj se i krahason me tiranët për nga kuptimi i vendit të parë, i bindur se edhe ai vetë ndodhet në këtë "betejë" për jetë a vdekje.

Nobeli, jo shkencëtari suedez, por çmimi në emër të tij është, gjithashtu, një nga ato kulmet e bukurisë së kësaj vepre. Autori ynë është i vetëdijshëm që çmimi Nobel, në veçanti për letërsinë, është nga çmimet më të larta që mund të marrë një autor për punën e tij krijuese. Shumë nuk mendojnë kështu, bile edhe autori i këtyre radhëve e ndan këtë mendim, sepse ka mendje të ndritura, intelektualë, pothuaj të pakapërcyeshëm për epokën së cilës i takojnë dhe nuk e kanë pranuar një nder të tillë, e kanë injoruar në kuptimin e plotë të fjalës. Për shkrimtarin tonë të madh I. Kadare, është i vetmi çmim që padrejtësisht s'iu ka ndarë nga Akademia suedeze. Ai me të drejtë e ëndërron këtë jo për mëshirë, por pse ai e meriton katërçipërisht si një artist i veçantë. Edhe për çmimin Nobel Kadare e ka bërë krahasimin midis Rusisë dhe Shqipërisë. Me një elegancë të pashoqe ai i ofron lexuesit dy tablo jete nga dy shtetet. Përderisa Pasternakut iu kishte ndarë çmimi Nobel për letërsi, atij nuk i lejohet asnjëherë për të shkuar dhe për ta marrë atë çmim në mënyrë ceremoniale. Midis atij dhe shtetit komunist dhe Çmimit Nobel ishte ngritur një mur i parrënuar përgjithmonë. Kështu kjo mbeti vetëm "ëndërr" e pasternakut, pasi ai ka lënë këtë botë para se të rrëzohet edhe diktatura komuniste në rusi. Në anën tjetër, Kadareja ynë, po ashtu ëndërron ta ketë edhe këtë çmim, çmimin kampion për letërsi?! Po ç'është ky çmim? Një letër e pavlerë e Akademisë së Shkencave suedeze e cila peshon rreth 900 mijë dollarë amerikanë. Pra ata 900 mijë dollarë janë vërtet të pavlerë kur të renditësh para apo pas shkrimtarëvesi Peter Handke e Andriç. Pranë emrit të Pasternakut apo Sartrit francez do të ishte më vlerë se ajo paçavure suedeze së bashku me ata 900 mijë dollarët amerikanë. Akademia Suedeze çuditërisht e ka degraduar atë çmim, dikur vërtet të vlefshëm dhe domethënës, duke bërë laureatë personalitete të papersonalitet. Por, cilat mund të jenë arsyet që Akademia Suedeze nuk ia ndan këtë çmim shkrimtarit tonë, i cili për më shumë se dy dekada është kandidat e shumë herë edhe favorit? Është shkruar dhe folur disa herë, është shkruar dhe përfolur deri edhe tek emra konkretë, kinse edhe nga shqiptarë që paskan deponuar fakte dhe arsye pranë Akademisë Suedeze të cilat flasin kundër dhënies së këtij çmimi për shkrimtarin tonë. Këto diskutime apo thashetheme janë degjeneruar duke kaluar deri në shkallën më të ulët të intelektit njerëzor. Ata të cilët e njohin jetën dhe veprën e Kadaresë dhe nuk janë të ndikuar nga emocione, cilado qofshin ato, subjektive a edhe objektive, e dinë që një pjesë e mirë e krijimtarisë letrare e autorit tonë të dashur janë elozhe për socializmin, komunizmin dhe udhëheqësin e saj në Shqipëri, E. Hoxha. Në aspektin e letërsisë artistike kanë qenë dhe do të mbesin art i përkryer, as shkrimtari ynë kurrë nuk i ka mohuar. Krahas, para dhe pas tij ka plot shkrimtarë që i patën kushtuar himne asaj epoke. Dritëro Agolli është nga të shumtit dhe nga më të veçantët, por ky shkrimtar i madh pat guximin edhe për të kritikuar kur guxoj ta shkruante romanin e famshëm "Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo". Krijimtaria letrare dhe publicistike e I. Kadaresë pas fillimit të viteve të '90-ta të shekullit që iku para 20 vjetësh, mori udhën e kriticizmit kundër sistemit komunist. Kjo krijimtari letrare dhe publicistike, të themi e një epoke të re, pa dyshim se është, gjithashtu, e nivelit më të lartë artistik. Kjo në pamje të parë lë për t'u kuptuar që, Ismail Kadare dëshiron të jetë dhe të quhet shkrimtari i parë disident në Shqipëri, gjë që është e pamundur, për vetë faktin se autori ynë mund të merret si shkrimtar i oborrit e, mbi të gjitha, ai mbante edhe poste politike në atë kohë. Kjo sjellje autorin tonë e vë në pozicion kontradiktor me vetveten. Por, e tëra, parë në aspektin thelbësor, Kadare gjithmonë ka pasur stilin e një "rebeli" në artin letrar. Kjo farë lloj disidence, nëse na lejohet ta quajmë kështu, po të vërehet me kujdes vepra e tij letrare edhe e kohës komuniste, vërehet kollaj ajo farë disidence. Po qe se kjo është arsyeja e refuzimit apo e injorimit për poetin tonë të çmuar, domethënë aspekti politik, nuk kanë të drejtë, ose fare pak. Nëse arsyet janë, e këto s'mund të jenë letrare, plot intelektualë shqiptarë, bile mendje të ndritura në nivel ndërkombëtar si dhe si një shkrimtar i përkthyer në mbi tridhjetë gjuhë të huaja, dhe unë vetë nga më të fundit, mendojnë se Kadare qëndron shumë shkallë më lart se shumë posedues të këtij çmimi, sidomos i paarritshëm për autorë si ky i këtij viti, Peter Handke. Në një pikë janë të përbashkët si kritikuesit, po ashtu adhuruesit e veprës kadareane. Ai ka intuitën e jashtëzakonshme të shkrimtarit. Muza e poetit jeton gjithmonë e zgjuar brenda shpirtit të tij.

Ismail Kadare, në moshën e tij të thyer, mund të themi, ka sjellë në dorën e lexuesit të dy krahëve, të cekur më parë, një roman me cilësitë më të larta të nivelit botëror. Kjo vepër letrare, mendoj, do të renditet përkrah veprave më të mira të letërsisë. Besoj se nuk do të dal i guximshëm po të shprehem se do të stivohet në rresht me të atyre patriarkëve të letërsisë botërore.

Po e mbyll këtë vështrim të shkurtër duke qenë i bindur se edhe Ismail Kadare së bashku me Pasternakun dhe Sartrin, pra të atyre që e ëndërruan dhe atyre që e refuzuan, do të qëndrojë shekujve mbi atë çmim.

## Pence dhe Pompeo në Ankara, presion ndaj Erdoganit

ANKARA, 17 TETOR - Delegacioni i lartë amerikan, i kryesuar nga nënpresidenti Mike Pence, është takuar me presidentin e Turqisë, Rexhep Tajip Erdogan, në përpjekje për të siguruar një armëpushim në Siri.
Ofensiva turke në veri të Sirisë ka hyrë në ditën e nëntë dhe shqetësimet ndërkombëtare për një krizë të re humanitare dhe ringjalljen e grupit militant ekstremist, Shteti Islamik, janë në rritje.
Pence dhe Erdogani mbajtën një takim kokë me kokë për rreth 90 minuta dhe më pas të dy delegacionet filluan një takim të përbashkët.
Delegacioni amerikan, në të cilin gjendet edhe sekretari amerikan i Shtetit, Mike Pompeo, pritet të paralajmërojë Erdoganin për sanksione shtesë nëse ai nuk e ndal ofensivën.
Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, tashmë ka vendosur disa sanksione ndaj Turqisë, por ka thënë se shpreson që vizita e Pences dhe Pompeos "do të jetë e suksesshme".
Nëse bisedimet dështojnë, "sanksionet, tarifat dhe gjërat e tjera që ne do të vazhdojmë t'i ndërmarrim do të jenë shkatëruese për ekonominë e Turqisë", ka thënë Trumpi.
Turqia e filloi ofensivën në Siri pas tërheqjes së trupave amerikane nga veriu i vendit, të cilat bashkë me forcat kurde kishin luftuar kundër grupit ekstremist Shteti Islamik.
ShBA-ja, pasi vendosi të tërhiqet, i bëri thirrje Turqisë të ketë kujdes me veprimet e saj. Mirëpo presidenti turk, Rexhep Tajip Erdogan, ka thënë se nuk do ta ndalë ofensivën derisa luftëtarët kurdë, të cilët Ankaraja i konsideron terroristë, t'i dorëzojnë armët.



# Demokratët shtojnë masat e hetimit për presidentin Trump

Ish-zyrtarë të administratës së presidentit Trump kanë dëshmuar me dyer të mbyllura në Kongres gjatë gjithë javës, ndërsa demokratët vazhdojnë të mbledhin të dhëna për argumentin e tyre se Trumpi kishte bërë përpjekje për ndërhyrje të huaj në zgjedhjet e vitit 2020



UASHINGTON, 17 TETOR - Hetimi për procedurën e shkarkimit të presidentit Donald Trump u shtua të mërkurën ndërsa ligjvënësit u kthyen në Uashington pas një pushimi dyjavor. Ish-zyrtarë të administratës së presidentit Trump kanë dëshmuar me dyer të mbyllura në Kongres gjatë gjithë javës, ndërsa demokratët vazhdojnë të mbledhin të dhëna për argumentin e tyre se Trumpi kishte bërë përpjekje për ndërhyrje të huaj në zgjedhjet e vitit 2020.
Ishte një javë e ngarkuar me intervista për demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve që po mbledhin të dhëna për procedurën e shkarkimit. "Nuk besoj që kemi arritur deri atje. Kemi akoma shumë gjëra për të bërë. Dhe po i bëjmë", tha Eliot Engel, kryetar i Komisionit për Marrëdhënie me Jashtë, ka njoftuar voa. Sipas ankesës së informatorit, presidenti e bllokoi ndihmën ndaj Ukrainës në këmbim të ndihmës kundër rivalit të tij, Joe Biden dhe të birit të tij, duke bërë që kreu i Komisionit të Zbulimit, Adam Schiff, të kërkonte urdhra gjykate për të marrë më shumë informacion, që deri tani administrata e Trampit i ka refuzuar.
"Argumentet për pengim të drejtësisë po shtohen", tha ai.
Presidenti Trump po argumenton se nuk do të bashkëpunojë deri kur demokratët e Dhomës së Përfaqësuesve të mbajnë një votim për ta zyrtarizuar hetimin. Kryetarja Nancy Pelosi thotë se kjo është një lojë për ta sabotuar kongresin. "Ne nuk jemi këtu për të luajtur. Jemi këtu për ta gjetur të vërtetën, për ta mbrojtur Kushtetutën e Shteteve të Bashkuara", tha Pelosi.
Por presidenti tha se Pelosi dhe demokratët po bëjnë lojëra politike. "Është një çmenduri e vërtetë. Mjafton të lexoni transkriptin e telefonatës. Është rast shumë i thjeshtë. Ata janë të dëshpëruar sepse e dinë që do t'i humbin zgjedhjet", tha ai.
Schiff, që ka nervozuar republikanët, përballet me një votë pakënaqësie nga një nga aleatët e Trumpit në Kongres. "Nuk ka asgjë që të justifikojë procedurën e shkarkimit në atë telefonatë. Dhe nëse kryetarja e Dhomës së Përfaqësuesve do të kishte pritur 48 orë për transkriptin, Amerika nuk kishte pse të përjetonte këtë gjë", tha Kevin McCarthy, udhëheqës i pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve.
Demokratët përballen me presionin për të mbajtur një votim për procedurën e shkarkimit deri në fund të vitit, në mënyrë që të bëhet para fillimit zyrtar të fushatës presidenciale. Megjithatë disa thonë se kjo nuk përbën shqetësim. "Është e rëndësishme të theksojmë se ne nuk po ngutemi, të mos krijojmë përshtypjen se na jep kënaqësi që e bëjmë një gjë të tillë, se synimi ynë i vetëm është të shkarkojmë presidentin", tha Sheila Jackson Lee, anëtare demokrate e Kongresit.
Hapi i mëtejshëm i demokratëve është të mësojnë më shumë për këmbimet mes zyrtarëve të Trumpit, përfshirë ish-ambasadorin amerikan në Bashkimin Evropian, Gordon Sondland i cili ka dëshmuar të enjten.

## Arrihet marrëveshja e re për Brexitin

LONDËR, 17 TETOR - Britania e Madhe dhe Bashkimi Evropian janë pajtuar për një marrëveshje të re për Brexitin. Marrëveshja mes dy delegacioneve është arritur para se të mbahet një takim i nivelit të lartë të Bashkimit Evropian.
Të dyja palët kanë punuar në tekstin ligjor të një marrëveshjeje, por do të ketë ende nevojë për miratimin e parlamenteve të Britanisë së Madhe dhe atij evropian.
Arritjen e marrëveshjes e konfirmoi kryeministri britanik Boris Johnson në rrjetin social "Twitter".
"Ne kemi marrë një marrëveshje të re", shkroi Johnsoni.
Edhe presidenti në largim i Komisionit Evropian, Jean Claude Juncker, njoftoi për arritjen e marrëveshjes, duke thënë se negociatorët e BE-së dhe të Britanisë së Madhe kanë arritur një marrëveshje që do ta mundësojë daljen e vendit nga Bashkimi Evropian. "Kur ka një vullnet, ka një marrëveshje dhe ne kemi një! Ashtë një marrëveshje e drejtë dhe e ekuilibruar për BE-në dhe Britaninë e Madhe", shkroi Juncker.
Afati për daljen e Britanisë së Madhe nga Bashkimi Evropian është 31 tetori.
Deri më tash palët kanë pasur mosmarrëveshje kryesisht për shkak të kontrolleve në kufirin irlandez, pas Brexit-it.
Një marrëveshje e negociuar nga ish-kryeministrja britanike, Theresa May, ishte refuzuar disa herë nga Parlamenti britanik.
Udhëheqësi i laburistëve opozitarë, Jeremy Corbyn, tha se marrëveshja e re duhet të refuzohet nga ligjvënësit, pasi ajo duket se është "edhe më e keqe" sesa ajo që u negociua nga ish-kryeministrja May.




Shijo
Pranverën
me...
Jaffa Champion PLUS
A+C+E
Multifrutti
Taste of World Wide Brand!
2L
Jaffa Champion


AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"
Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë
Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.
Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

E jashtëzakonshme

## Kapet gjarpri gjigant, i gjatë katër metra dhe me peshë rekord

Fondacioni 'Krabi Pitakpracha Foundation' ka shpërndarë imazhet e pazakonta të kapjes së një gjarpri kobra gjigant. Në fotografi shihen veterinerët duke treguar gjarprin katër metra të gjatë dhe me një peshë që është cilësuar rekord. Bëhet fjalë për një gjarpër prej 15 kilogramësh, i cili sillej rrugëve të provincës së Krabi, në jug të Tajlandës.



FOTO E DITES



Pinguinët shihen në veri të Stanleyt në Ishujt Falkland. /AP/

E rrallë

## Zbulohen milingonat më të shpejta në botë



Dunat e rërës në Saharanë veriore janë shtëpia e milingonave më të shpejta në botë. Pamjet e publikuara në media tregojnë milingonat që ecin përmes rërës së nxehtë me një shpejtësi rreth një metër për sekondë. Mendohet se shpejtësia e madhe me të cilën ecin milingonat ka të bëjë me përshtatjen e tyre në shkretëtirë.

## BARSOLETA E DITËS



Dy të dehur, kur dalin prej kafes, shkojnë te një taksist që ishte aty afër dhe e pyesin:
- Sa kushton deri në Krujë për tre persona?
Taksisti i pyet:
- Pse tre?! Ju jeni dy.
Të dehurit i thonë:
- Po ti, nuk do të vish me ne?

KINO ABC PRISHTINE

## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Vetem gjatë vikendit në ora 14:00

### ABOMINABLE 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 ore 32 min

Rolet: Chloe Bennet, Tenzing Norgay Trainor, Albert Tsai, Eddie Izzard, Sarah Paulson, Tsai Chin, Michelle Wong, etj.
Regjia: Jill Culton







Çdo ditë në ora 16:00

### TOY STORY 4 / 3D

I Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 40 min

Rolet: Tom Hanks (Woody), Annie Potts (Bo Peep), Tim Allen (Buzz Lightyear), Tony Hale (Forky), Keegan-Michael Key (Ducky), Jordan Peele (Bunny), Wallace Shawn (Rex), John Ratzenberger (Hamm), Keanu Reeves (Duke Caboom), etj.
Regjia: Josh Cooley

Çdo ditë në ora 18:00 dhe 20:00

### MALEFICENT MISTRESS OF EVIL 3D

Aventurë/Familjar/Fantazi; 1 orë 58 min

Rolet: Angelina Jolie, Elle Fanning, Chiwetel Ejiofor, Sam Riley, Ed Skrein, Imelda Staunton, Juno Temple, Michelle Pfeiffer, etj.
Regjia: Joachim Ronning







Çdo ditë në ora 22:00

### ZOMBIELAND DOUBLE TAP

Aksion/Komedi/Horror; 1 orë 39 min

Rolet: Woody Harrelson, Jesse Eisenberg, Emma Stone, Abigail Breslin, Rosario Dawson, Zoey Deutch, Luke Wilson, etj.

Regjia: Ruben Fleischer

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Marsi do të jetë planeti më i favorshëm gjatë këtij dite për jetën tuaj në çift.



**DEMI**
Ditë harmonike dhe e mbushur me gëzim kjo për të gjithë të dashuruarit.



**BINJAKËT**
Gjatë kësaj dite mund të përballeni me ndonjë vështirësi në jetën tuaj sentimentale.



**GAFORRJA**
Në aspektin ekonomik do t'ju duhet të mendoni disa herë para se të ndërmerrni ndonjë investim.



**LUANI**
Bëni shumë kujdes me xhelozinë e tepruar gjatë kësaj dite, sepse atmosfera në çift mund të ndërlikohet së tepërmi.



VIRGJËRESHA
Do t'ju duhet të bëni ndonjë ndryshim në aspektin e pamjes fizike për ta tërhequr vëmendjen e dikujt.



PESHORJA
Aspekti financiar nuk është shumë i kënaqshëm sot.



**AKREPI**
Do t'ju duhet të realizoni disa biseda serioze për t'i vënë pikat mbi 'I' në një sërë çështjesh.



**SHIGJETARI**
Bëni kujdes me lojërat e fatit. Sot shansi nuk do t'ju ndihmojë në këtë fushë.



BRICJAPI
Nëse jeni duke kaluar nëpër disa çaste trishtimi, përpiquni të kaloni disa çaste pozitive me disa persona te të cilët besoni.



**UJORI**
Mundohuni t'i shmangni keqkuptimet duke u thelluar në komunikim.



**PESHQIT**
Parashikohet të kaloni më shumë kohë me partnerin.

# Nicki Minaj ka thënë se javën e ardhshme pritet të martohet



Reperja e njohur Nicki Minaj ka thënë se javën e ardhshme do të martohet me të fejuarin e saj Kenneth Petty. Sipas "Daily Mail", Minaj këtë e tha në një intervistë për "E!News". "Ne kemi marrë licencën për martesë, por unë dua që neve të na martojë një prift i veçantë dhe ai tani më ka konfirmuar se mund të jetë në dasmën tonë. Kështu, shtatë ditët e ardhshme pritet që ne të martohemi", ka deklaruar Minaj.

# Miley Cyrus bën tatuazh të ri



Aktorja e njohur Miley Cyrus javën e kaluar për herë të parë e bëri zyrtare lidhjen e saj të dashurisë me australianin, Cody Simpson. 26-vjeçarja për 100 milionë ndjekësit e saj në "Instagram" ka publikuar një fotografi, ku i njofton ata se ka bërë tatuazh të ri. Ky tatuazh ka numrin 92, që i bie të jetë viti i lindjes së yllit botëror.






# Jennifer Lopezi xhiron filmin e ri "Marry Me"

Filmi Hustlers u bë një ndër më të popullarizuarit, por Jennifer Lopezi me siguri nuk ka humbur shumë kohë për t'u kthyer në punë sepse menjëherë u pa në setin e filmit të ri romancë-komedi "Marry Me" të hënën. Këngëtarja dhe aktorja 50-vjeçare doli me rroba krejt të bardha nga "Hotel Plaza" në Manhattan, Nju Jork City, pas një dite të ngarkuar me xhirime.

# Katy publikon këngë të re



Katy Perry është rikthyer me këngën e re të quajtur "Harleys In Hawaii". Këngëtarja 34-vjeçare e solli këtë këngë bashkë me videoklip i cili është xhiruar në Hawaii, drejtuar nga studioja me bazë në Barcelonë, "Manson". Kënga është punuar në bashkëpunim me Johan Carlsson dhe Jacob Kasher Hindlin.

# ODEON

## *(tregim)*



**Nga Murat ALIAJ**

Në fillim erdhi shpura perandorake e cila përgatiti mjediset ku do vendosej perandori, i cili e vizitonte për herë të parë Apolloninë. Atë sezon gjuetie ai do e kalonte në këtë vend të bekuar ku korintasit kishin vendosur gjithë perënditë e tyre. Më pas mbërriti edhe perandori romak Vetranio i cili ishte më i riu nga gjithë perandorët e mëparshëm. Sa kishte hipur në fron dhe po i shkelte me këmbë të gjitha qendrat më të rëndësishme të perandorisë. Sa më shumë kalonte koha, aq më shumë zhvlerësohej edhe posti i lartë i perandorit. Dikur atë e kishin drejtuar gjeneralë të dëgjuar si Augusti, Mark Aureli e Kostandini i Madh. Por edhe më rrënuesit si Hanibali e Neroni nuk ishin më pak të dëgjuar për shkatërrime e shkretime. Përkundrazi djaloshi Vetranio nuk kishte ndonjë histori që ta vendoste emrin e tij përkrah njerëzve më të dëgjuar të kohës, veç një dashurie të fuqishme për të bijën e perandorit Kostandin, i cili së bashku me të, i dhuroi dhëndrit edhe kreun e perandorisë. Djaloshi ishte i ri energjik dhe i bukur si skulpturat e lëmuara greke.

Kishte pasion artet dhe gjahun, ndaj vizitën e tij të parë vendosi ta bënte në këtë vend të afërm. Në Apolloninë e Ilirisë, që ngjante si një fron mbretëror të vendosur midis qiellit, detit e tokës. Apolonia, që zoti i dha shenjtërinë dhe e vërviti mes egërsirave për të njohur edhe barbarinë. E brishta Apolloni që me një harpë sfidonte shekujt e përgjakur. U bë vend i shenjtë Apollonia. U krijua amfiteatri dhe odeoni i madh qe i mbeti simbol qytetit. Këtu u luajtën tragjeditë e Eskilit dhe dramat e Sofokliut.

Edhe pse librat shkruheshin akoma me pergamenë e papirus, këtu u krijua biblioteka dhe…në lëndinën e shkurtër prej tempullit, deri aty ku niste rrëpira, u ndërtua odeoni, me gurë të gdhendur e me skulptura perëndish. Për dhjetë shekuj ajo mbeti vendi i shenjtë i krijimit. Qysh mbrëmjen e parë të mbërritjes në Apolloni, e para gjë që i bëri përshtypje Perandorit, ishte paqja e amshuar ku preheshin në mermer shëmbëlltyrat e perandorisë.

Ngjante sikur ky vend nuk kishte asnjë lidhje me luftërat që ndizte perandoria herë në një skaj e herë në tjetrin. Buzë mbrëmjes, ndërsa dielli e kishte përflakur perëndimin mbi Adriatik, Perandori bëri shëtitjen e parë në odeon. Ajo shëtitore përrallore me harqe që zbrisnin deri poshtë kodrinës, ishte e mbushur gjithë vepra arti. Fillonte me statujën e Apolonit me harpë, vazhdonte me Afroditën e pastaj vinin rresht perënditë e Olimpit.

Dy pëllumba të bardhë shkonin e vinin sa nga harpa e Apolonit e tek supi i Afroditës. Edhe shpendët s'ndjenin të ngopur nga madhështia e dorës njerëzore. Odeoni kishte mbet i paprekur, ashtu siç e kishin lënë të braktisur korinthasit. Pas largimit të tyre, qendra ishte kthyer në akademi ushtarake dhe siç dihet, ushtarakët nuk kanë shumë interes për armatat e vdekura, sado të bukura qofshin ato, përderisa janë të ndjekje të të gjallëve. Ndaj qysh në këtë vizitë të parë që po i bënte odeonit, Perandorit i lindi mendimi se edhe ai mund të bëhej i dëgjuar duke vënë dorë e zgjuar këtë botë të ngurosur.

Duke ndryshuar e përshtatur me kohën e tij, këtë madhështi të shkuar. Ai mund t'i jepte tjetër shkëlqim e ta kalonte atë që odeoni trashëgoi prej shekujve. I lindën edhe plot mendime të tjera, të cilat s'guxonte t'ia përmendte as vetes, pasi ato përmbanin herezi e kundërshti ndaj trashëgimisë së shekujve. Perandori hodhi shuma të mëdha për të grumbulluar në oborrin e tij skulptorë më të dëgjuar të perandorisë.

Krijoi i një atelie gjigande skulpture, e cila kishte për qëllim zbatimin e urdhrit të tij, për të zëvendësuar madhështinë e mitologjisë helene, me atë romake. Kaq i takonte atij të thoshte, pastaj ishte detyra e artistëve, që ta zbërthenin e konkretizonin detyrën. Aq i vëmendshëm u bë ndaj kësaj pune, sa çdo ditë e niste me vizitën në atelie dhe pasi përfundonte gjuetinë në kënetën poshtë këmbëve të kodrës, kthehej prapë aty të shikonte se ç'bëhej.

Për muaj të tërë skulptorët, s'po mundeshin dot të konceptonin pamjen e re të odeonit, ku do të mungonin ca kryevepra që duhej të zëvendësoheshin me të tjera. Punët e para ishin dështime që u morën kokën krijuesve të tyre. Skulptorët duhej të kuptonin se këtu nuk ishin grumbulluar për të ushtruar dorën. Misioni u bë i frikshëm dhe kërkimi, këmbëngulës. Këto skulptura duhej të kapërcenin mjeshtërinë helene të gdhendjes, ndryshe… do hanin të zotët.

Për një vit të tërë, u bënë vetëm makete të pasuksesshëm. Së fundi panë një shpresë që mund t'ia dilnin me sukses. Njeri nga skulptorët skaliti bustin e Perandorit dhe e vendosi në hyrje të punishtes. Në mëngjes, kur Perandori bëri vizitën e tij të zakonshme, u befasua aq shumë nga portreti i tij, sa po pyeste veten në ishte ai perandori i vërtetë, apo ishte zëvendësuar gjatë natës, nga ky djalosh i ngurtësuar në mermer. U shushat duke parë vetveten në atë pamje.

Për mbi një orë e soditi atë nga të gjitha anët, pa rrëfyer asnjë shenjë kënaqësie a neverie. Ajo orë pritje dhe ankthi, i ngjante kohës kur i dënuari pret të dëgjojë vendimin në se do i falet jeta, apo do i pritet koka. E dinin se në rast mospëlqimi, trupat e tyre do bëheshin ushqim i kafshëve të oborrit. Së fundi perandori shpërtheu me sa zë kishte dhe menjëherë pranë tij u gjend i përkulur skulptori.

Por perandori i kishte fjalët të kursyera. ?Bravo!- i tha? Exsellentia autem gemens in Graeco, Romani maiestatem ac gloriam (Tani përsosmëria helene, rënkon nën madhështinë romake. Latinisht) ?Nobilitatem vitae et salutis! (Jetë dhe shëndet shkëlqesisë suaj.- Latinisht) -u përgjigj skulptori me sytë drejt qiellit. Për skulptorin nuk shterën shpërblimet. U gjet së fundi çelësi që mund të hapte portën e shijeve të Perandorit. Tashmë problemi ishte bërë më e lehtë. Por në punën krijuese asnjëherë nuk janë të përjashtuara të papriturat.

Një mëngjes, ndërsa Perandori po bënte shëtitjen e zakonshme në odeon, i dëgjoi veshi një klithmë të çjerrë shpendi. Ktheu kokën dhe mbi supet e skulpturës së tij, dalloi një korb të zi që kërciste sqepin mbi mermer. Ç'do të thoshte kjo?! Ku kishin humbur pëllumbat që luanin me harpën e Apollonit? Skulptura duhej të fshihte ndonjë sekret, që ndërsa i zoti nuk e kuptonte dot, e kuptonin më mirë shpendët.

Ndoshta odeoni duhej izoluar derisa të përfundonte kompletimi. Kështu u bë dhe për gjithë kohët që hiqeshin statujat e vjetra e zëvendësoheshin me të reja, aty nuk u lejua të futej asnjë shpend… Skulptorët kishin zgjedhur problemin kryesor të zgjedhjes së objektit dhe kjo ua lehtësonte shumë punën. Tani duhej t'i kushtoheshin cilësisë dhe larmisë së objekteve që gdhendnin. Të gjithë kishin nëpër duar nga një skulpturë të portretit të Perandorit. Njeri duke e paraqitur me kupë në dorë, tjetri me shpatë, e i treti duke e paraqitur si një Apollon, me harpë në dorë. Shumëllojshmëri me të njëjtin objekt.

Kaq shumë portrete u bënë, sa brenda një kohe të shkurtër u zëvendësuan të gjitha skulpturat e mitologjisë helene, madje doli i nevojshëm edhe zmadhimi i odeonit. Me urdhër të Perandorit, nga galeria e punimeve të mëparshme u ruajt në odeon skulptura e Afroditës e cila s'mund të arrihej.

Po kështu nuk u konservua as skulptura e Apollonit, por përballë tyre u vendosën perënditë homologe romake, Venusin me Kupidin. Njëra më e hijshme se tjetra. Nuk u mor vesh se ç'deshi të thoshte perandori me këtë lëshim. Mbase iu tremb sherrit të perandoreshave, i cili është shumë më i tmerrshëm se luftërat e përgjakshme të perandorëve.

Dhe ato e pranuan njëra tjetrën duke e hijeshuar odeonin më shumë se të gjitha skulpturat e tjera. Ato ishin të përsosura gjer në imtësi, por që të mos prekej lavdia e perandorit, u lanë atje tek fundi. Pasi u kompletua i gjithë odeoni me skulpturat e perandorit, ato të perëndive helene u hoqën natën dhe u futën në një tunel, ku mbahej ushqimi i gjësë së gjallë, por ato nuk dolën më prej aty.

Ca thonë se u vodhën shekuj më pas nga bizantinët, e ca të tjerë ngulin këmbë se, pas ndryshimit të shtratit të Vjosës,



i mori rrjedha me vete e i varrosi thellë, për të mos e parë kurrë dritën e diellit. Për një kohë të shkurtër ato u harruan përpara shkëlqimit të ri që fitoi odeoni, i cili u mbush me variante të ndryshme të portretit të perandorit.
Ç'vlerë kanë perandoritë që nuk lënë pas të tilla gjurmë ekzistence? Zgjati shumë kohë zëvendësimi i statujave, por kur ajo përfundoi, lajmi u përhap me zulmë në të gjithë botën. Ngado vinin fisnikë për të parë odeonin dhe iknin të mrekulluar, nga sa kishin lënë pas. I vetmi që nuk e ndali punën, ishte perandori, që çdo mëngjes ngrihej nga gjumi i trembur dhe vërsulej në odeon për të parë se çfarë kishte ndodhur gjatë natës. E dinte se siç kishte bërë shumë admirues në gjithë botën, nuk ishin të paktë edhe armiqtë. Odeoni u bë meraku i tij i vetëm.
Mbase nga që kuptoi se akoma s'kishte arritur përsosjen. Diçka i mungonte dhe s'mund të kuptonte se çfarë. Kalonte nga njëra skulpturë tek tjetra duke medituar. "Këtu ku ka qenë paraardhësi August, ka më tepër hije ky Apollon me harpë, kurse këtu ku ka qenë Oktaviani, shkon më shumë ky djalë ëndërrimtar mbi kalë, i cili nuk shkon në luftë, por në parajsën qiell?tokë?det." Lumturia po e shndërronte në një Apollon dhe kjo i jepte një kënaqësi të frikshme.
Por jo me pak e shqetësonte edhe ajo…diçka që akoma mungonte. Sigurisht që duhej të ishte mungesë serioze, derisa pëllumbat s'po afroheshin më, t'i uleshin mbi supe, ndaj perandorin s'mund ta zinte gjumi pa e gjetur.
Çdo mëngjes të dilte në odeon e mbushej me ajrin e freskët të detit, e gjithashtu para gjumit dilte po aty dhe përshëndetej e përqafohej me shëmbëlltyrat e tij. Kur shtrihej për të fjetur në dhomën me dritare nga deti, gjumi e zinte me vizione të frikshme mitologjike. Me të po ndodhte diçka e çuditshme.
E zgjeroi punishten e mermerit dhe dyfishoi numrin e gdhendësve. Në kokë i lindi marrëzia për ta shtrirë odeonin, deri në det e ta mbushte nga të dyja anët me statuja. Mitologjia romake ishte një hambar i madh, ku asnjëherë s'do ndihej i varfër me heronjtë e tij. Fitoi kaq shumë famë odeoni, sa në çdo kohë vinin vizitorë nga të gjitha anët e perandorisë. Mrekulloheshin me sa u zinin sytë dhe largoheshin, për t'ua lënë vendin të tjerëve.
Atë mbrëmje sa ishte kthyer prej gjahut, kur pa se në odeon ishin dyndur turma vizitorësh si rrallë herë tjetër. Ndërsa mendonte se ishte mjaft pranë mrekullisë, ndodhi diçka e papritur. Qielli ishte i mbushur me magjinë e perëndimit bregdetar. Ca re të murrëtyera paralajmëronin prishje të motit.
I mbeti vështrimi në horizont, atje ku përziheshin ngjyrat e perëndimit, duke krijuar një tablo abstrakte. Në atë murmurimë mbrëmje iu duk sikur i zuri veshi disa krrokama. Ktheu kokën dhe syri i zuri një shpend të zi si nata, që fërkonte sqepin mbi mermerin e supeve të skulpturës.
Ptu!…pështyu i neveritur!-shpend i mallkuar i luftës! Unë pres që mbi supet e mi të dashurohen pëllumbat e të këndojnë bilbilat, ndërsa s'po më ndahen korbat! Dhe ishte koha kur odeoni ishte mbushur gjithë vizitorë, asnjërit nuk i bënte përshtypje krrokama e korbit, ndërsa ishin ndalur në fund të odeonit dhe po shijonin mrekullitë e Afroditit e Venusit. Kupidit dhe Apollonit.
Çfarë kishte të veçantë atje që kishte mbërthyer vizitorët? Ç'ishin këta njerëz që s'dinin të nderonin të zotin e vendit e të qiejve? Nga vinin ata? Kjo mospërfillje po përsëritej gjithnjë e më dendur. Ajo e revoltonte dhe e xhindoste. Ashtu i rrëmbyer u vërsul drejt odeonit që t'i lante hesapet me ta, por përpara korbit u shtang. Vetëm ai kishte mbetur si adhurues i Perandorit.
Këmbët nuk e mbajtën dhe u rrëzua tek trupi i skulpturës së tij, duke mbetur përjetësisht si një Pigmalion i dashuruar me skulpturën e vetvetes./*Mapo*

# Paris në vjeshtë



**Jetona KOÇIBELLI**

Kur ecën nëpër rrugicat e Parisit gjithçka në atmosferë të flet për të mirat e jetës. Aty lindi moda, shampanja, u zhvillua arti, u përsos shija. Dritaret janë të mëdha, ndërsa shtëpitë nuk kanë pse të duhen me hapësirë. Ti e shijon gjithçka në kafene dhe restorante.
Mjafton thjesht të thuash Paris, dhe magjia është aty. Të shohësh arkitekturën unike e perfekte, dritaret shpesh me lule, rrugët e pastra, të ndjesh aromën e mirë të bukës, apo croissant-it në mëngjes dhe shijen e hollë të një gotë vere në mbrëmje.
Megjithatë çdokush e njeh këtë qytet për të tillë ajo që të ngacmon është respekti që Franca ka për historinë dhe figurat e saj. Në kompleksin e pallateve Les Invalides, ka një qetësi solemne. Rrethuar nga muzeume dhe monumente, të gjitha të lidhura me historinë ushtarake të Francës, apo një kishë e madhe, më e larta në Paris me një kupolë prej 107 metrash, me varret e disa nga heronjve më të mëdhenj të Francës, më i njohuri Napoleon Bonaparte.
Përveç tij, hiri i një numëri të konsiderueshëm të personaliteteve franceze është këtu, si i biri i Napoleonit, l'Aiglon mbreti i Romës, vëllezërit e tij, Joseph dhe Jerome Bonaparte, gjeneralët Bertrant dhe Duroc etj. Ndërsa pak më tutje, Obelisku të cilin ai e solli si triumf nga Egjipti zë vend krenar në sheshin më të madh të Parisit, La Concorde. Francezët sot mburren ende për kodin dhe ligjet e tij, për të të kujtuar gjithmonë që ata janë vendi i lirisë dhe demokracisë.
Në Muzeun e Armëve, gjithçka tjetër të flet për fuqinë, e pushtetin. Për luftërat, humbjet e fitoret. Duke të lënë të kuptosh se asgjë e madhe nuk mund të arrihet lehtësisht. Se ashtu si Napoleoni kishte premtuar, ushtarët e Francës meritojnë të kthehen në vendin e tyre, vetëm duke kaluar poshtë Harkut të Triumfit.
Kur sheh Hotel le Crillon, menjëherë e lidh me faktin që kjo godinë historike, ka shërbyer si shtëpi e Mbretit Luigji I XVI dhe Mbretëreshës Marie Antoinette. Dhe po këtu përballë në sheshin La Concorde, atyre ju pre koka në gijotinë, përgjatë Revolucionit Francez, më vitin 1793. Megjithatë 'Requiem in C minor' nga Luigi Cherubini e shkruar më 1816, u bë për nder të kujtimit të tij.
Vështirë mos të lenë shenjë fjalët e Paul Valery, të shkruara me gërma ari në Trocadero, në Pallais de Chaillot të Parisit kushtuar të rënëve në betejë.
Varet nga ty udhëtar që kalon këtu
Nëse do më quash varr apo thesar
Nëse unë flas apo rri i heshtur varet vetëm nga ty
Miku im, mos hyr këtu nëse nuk ke dëshirë.
Historia bën çmos për të nderuar emrat e mëdhenj të saj. Për Molierin ka një shatërvan sëbashku me monumentin e tij, në kryqëzimin e rrugëve Moliere dhe de Richelieu. Së bashku me një nënshkrim, i pari për në monument përkujtimor kushtuar një figure jo ushtarake në Francë.
Nga ana tjetër mund të flasësh për varrezat e Pere Lachaise, ndoshta më të veçantat në botë. Shtëpinë muze të Victor Hugo në Place des Vosges, një arkitekturë e mrekullueshme. Po ashtu të ruajtura me kujdes e fanatizëm ndaj origjinales kafet historike Les Deux Magot dhe le Flore në Saint Germain des Pres. Aty ku shkruanin Heminguei, Sartre, Simone de Beauvoir…
Ky Paris këtë vjeshtë më bëri të mendoj për historinë, për respektin e figurave të së shkuarës, për respektin ndaj dinjitetit njerëzor, për çmuarjen e vlerave, për krenarinë që mbarin ato.
Nga e gjitha kjo më shkundi zhurma e lajmit më të rëndësishëm 10 tetorit. Ora 13:00, çmimin Nobel në letërsi e kishte marrë shkrimtari austriak Peter Handke. Në Parisin gri të asaj dite edhe gjykimin e këtij vendimi serish e lidha me historinë. Vetëm koha është ajo që i vendos në sitë ngjarjet dhe emrat. Dhe aty për aty më erdhi sërish në mend Sartre, që e refuzoi këtë çmim.
Kujtimi i fundit që më vjen ndërmend është nxitimi për në aeroport, sëbashku me të edhe shoferi i taksisë, Skander quhej, një francez me origjinë pakistaneze. Tha që vërtet kishte një origjinë pakistaneze, por e kishte për krenari ta quante veten francez. Po flas si francez tha; ndërkohë po më tregonte se si në tërësi propaganda punonte kundër njerëzve me ngjyrë dhe myslimanëve. Para disa ditësh u vranë katër vetë dhe ekzekutori u cilësua si mysliman, vetëm se kishte një lëkurë të zeshkët, por në fakt nuk ishte i tillë. Gjithë java kaloi duke u marrë me të, kështu humbi vëmendja nga probleme më të rëndësishme. Pastaj më pyeti nga isha:
Shqipëria i thashë. Aha, vendi i makinave të shtrenjta dhe krimit-ma priti. Kam parë mjaft reportazhe për këtë.
Jo, jo nuk është e vërtetë-i thashë. Është e gjitha propagandë, si kjo qe sapo më përmende. Nuk foli./*gazeta-shqip*





Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

# Ymeri: Barazim i merituar ndaj Prishtinës, Drenica meriton rezultate më të mira

Portieri i Drenicës, Arion Ymeri, për "Epokën e re" ka thënë se skuadra kuqezi nga Skenderaj e meritoi barazimin ndaj Prishtinës në "Fadil Vokrri". "Ne ishim përgatitur maksimalisht që mos të pësojmë humbje në këtë ndeshje dhe ia arritëm qëllimit me plot mund dhe shumë meritë", ka thënë Ymeri

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 17 TETOR - KF Drenica nga Skenderaj po ka probleme financiare dhe klubi nuk i ka kryer obligimet ndaj futbollistëve dhe shtabit teknik, por kjo nuk e ka penguar skuadrën kuqezi të dalë e pamposhtur nga ndeshja ndaj Prishtinës e zhvilluar të mërkurën në stadiumin "Fadil Vokrri".
Portieri i skuadrës së Drenicës, Arion Ymeri, të enjten për "Epokën e re" është shprehur i kënaqur me atë që ka treguar skuadra e tij përballë Prishtinës por, sipas tij, për të nxjerrë një pikë në kryeqytet është punuar shumë dhe angazhimi ka qenë maksimal. "Secila ndeshje ndaj Prishtinës gjithmonë është e vështirë, sepse është një klub i madh në Kosovë dhe, siç e dimë të gjithë, ata kanë ekip shumë cilësor, por ne ishim përgatitur maksimalisht që mos të pësojmë humbje në këtë ndeshje dhe ia arritëm qëllimit me plot mund dhe shumë meritë. Dua t'i përgëzoj bashkëlojtarët për angazhimin maksimal të cilët janë fantastikë", ka thënë Ymeri.
Ndeshjen e radhës Drenica sërish e zhvillon në kryeqytet, por këtë herë përballet me Flamurtarin. Numri një në portën e Drenicës, Arion Ymeri, ka shprehur optimizëm se edhe nga kjo ndeshje do të dalin me rezultat pozitiv. "Edhe ndeshja ndaj Flamurtarit është shumë e vështirë dhe e rëndësishme për të dy ekipet. Besoj se do të jetë një lojë e fortë nga të dyja palët dhe ne shkojmë për rezultat pozitiv. Kam besim se pas paraqitjes ndaj Prishtinës do t'ia dalim edhe në këtë ndeshje që të dalim të pamposhtur", ka shtuar ai.
Drenica, pas nëntë xhirove të zhvilluara në elitë, pozicionohet në vendin e tetë me 10 pikë. Portieri Ymeri nuk është edhe aq i kënaqur me këto pikë të grumbulluara, por ka shprehur besimin se kjo do të ndryshojë në xhirot e ardhshme. "Jemi të kënaqur deri-diku sepse kemi mundur të bëjmë ndoshta edhe më shumë, mirëpo ne do të mundohemi që pikët e humbura deri më tani t'i kompensojmë me ndeshjet e mbetura që të grumbullojmë sa më shumë pikë dhe në fund mos të diskutohet mbijetesa", ka përfunduar portieri kuqezi.



### Sot zhvillohen tri ndeshje

Sot (e premte) zhvillohen tri ndeshje të javës së dhjetë në IPKO Superligën e Kosovës. Ndeshje interesante do të zhvillohet në Drenas, ku skuadra kampione, Feronikeli, e pret Gjilanin. "Nikli" synon t'u rikthehet fitoreve pas barazimit në ndeshjen e fundit ndaj '89-shit, kurse Gjilani synon ta nxjerrë të paktën një pikë nga kjo ndeshje. Ndeshje shumë interesante do të zhvillohet edhe në Podujevë, ku skuadra e Llapit do ta presë Trepçë '89. Ndeshja tjetër zhvillohet në Klinë në mes të dy skuadrave të fundit në tabelë, Dukagjinit dhe Vushtrrisë.

**IPKO SUPERLIGA**

**Të premten takohen:**
**Dukagjini - Vushtrria**
**Feronikeli - Gjilani**
**Llapi - Trepça '89**

**Të shtunën takohen:**
**Flamurtari - Drenica**

**Të dielën takohen:**
**Drita - Ballkani**
**Ferizaj - Prishtina**
**(Të gjitha ndeshjet zhvillohen nga ora 14:00)**

## Laura, e bronztë në Kampionatin Botëror



PRISHTINË, 17 TETOR - Laura Fazliu ka fituar medaljen më të rëndësishme në karrierën e vet. Xhudistja e Kosovës fitoi të bronztën në Kampionatin Botëror për Juniorë (U-21) që po mbahet në Marrakech të Marokut.
Fazliu në luftën për të bronztën përmes repesazhit mposhti me ippon Renata Zachovan e Republikës së Çekisë, kategoria - 63 kg. Garuesja jonë fitoi pesë luftëra, ndërsa pësoi një humbje në çerekfinale. Botërori i juniorëve shërben edhe për pikë olimpike Tokio 2020.

# Çekia, masa të rrepta sigurie për ndeshjen me Kosovën



PRAGË, 17 TETOR - Kosova vazhdon të besojë te kualifikimi për në 'Euro 2020' teksa dy ndeshjet e ardhshme janë vendimtare për ta përcaktuar fatin e "dardanëve". Ekipi i drejtuar nga Bernard Challandes më 14 nëntor ka një ndeshje të rëndësishme siç është ajo kundër Çekisë në transfertë, ndeshje e cila do të përcaktojë se cila nga këto dy kombëtare do të vazhdojë më tej. Në prag të kësaj sfide të rëndësishme vendi pritës, që është Çekia, ka vendosur të marrë masa të rrepta sigurie, për të parandaluar ndonjë incident apo thirrje politike gjatë zhvillimit të ndeshjes. Federata çeke ka ndryshuar edhe shitjen e biletave, të cilat do të blihen vetëm nga personat fizikisht dhe jo online, siç ishte parashikuar.
Kreu i Federatës së Futbollit i Çekisë, Martin Malik, u ka kërkuar tifozëve t'i shmangin thirrjet politike, pasi diçka e tillë nuk lejohet nga UEFA. "Ndeshja e 14 nëntorit është e një rreziku të lartë dhe ne do të mundohemi ta garantojmë sigurinë në stadium. UEFA na e ka bërë të qartë se asnjë thirrje politike apo raciste nuk do të tolerohet. Ajo është e gatshme të japë dënime shembullore. U bëj thirrje tifozëve të shmangin çfarëdolloj thirrje politike kundër Kosovës", ka thënë Malik.

## FFK-ja nuk e kursen Llapin

PODUJEVË, 17 TETOR - Komisioni Disiplinor i Federatës së Futbollit të Kosovës nuk e ka kursyer aspak skuadrën e Llapit. Ky klub, për shkak të lëshimit në organizim të ndeshjes ndaj Ferizajt, është dënuar me zhvillimin e dy ndeshjeve pa shikues. Ndërsa kapiteni i kësaj skuadre, Mentor Zhdrella, nuk do të ketë të drejtën e paraqitjes në tri ndeshjet vijuese që Llapi i zhvillon në Superligë. Me katër ndeshje ndalim të kryerjes se funksionit në klub është dënuar ndihmëstrajneri Burim Zhjeqi, ndërsa vërejtja e fundit i është shqiptuar futbollistit Liridon Leci, i cili, sipas njoftimit, nuk ka pasur sjellje të duhura pas ndeshjes Drenica - Drita. Edhe klubit të Gjilanit i është tërhequr vërejtja e fundit, pasi shikuesit e tij kanë hedhur shishe në fushë.



## Cimili publikon listën e futbollistëve për rrethin e dytë kualifikues

PRISHTINË, 17 TETOR - Përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës në futsall, Ramadan Cimili, ka publikuar listën e futbollistëve me të cilët do të paraqitet në rrethin e dytë kualifikues për Botërorin 2020, që mbahet prej 23 deri më 28 tetor në Maqedoninë e Veriut. Grumbullimi i ekipit do të bëhet më 20 tetor në hotel "Venus" në Prishtinë në orën 11:00. Ndeshjen e parë Kosova do ta luajë kundër Ukrainës, më 24 tetor në orën 17:30, ndeshjen e dytë kundër Maqedonisë së Veriut më 25 tetor, po ashtu në orën 17:30 dhe ndeshjen e fundit kundër Sllovenisë, më 27 tetor, në orën 20:00.
Lista e futbollistëve: Ramadan Alaj, Vahid Krasniqi, Fredi Prenqi, Bajram Ramadani, Malush Qerimi, Ylli Mazreku, Dardan Topilla, Fitim Krasniqi, Drilon Paqarrizi, Mërgim Dervishaj, Jeton Rukovci, Oso Gjinovci, Getart Hyseni, Drilon Maxharraj.



# Ademi: Një person mund t'i blejë vetëm dy bileta për ndeshjen ndaj Anglisë



PRISHTINË, 17 TETOR - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Agim Ademi, ka folur në lidhje me shitjen e biletave për ndeshjet e Përfaqësueses së Kosovës. "Dardanët" po zhvillojnë ndeshje të mëdha që nga emërimi i Bernard Challandesit trajner. Forma e lartë e fitoreve dhe loja e mirë kanë bërë që tifozët të kenë shumë kërkesa dhe interesim për ta shikuar nga afër Kosovën. Megjithatë, shitja e biletave po bëhet në mënyrë shumë të shpejtë dhe shumë tifozë nuk po kanë mundësi t'i shikojnë "Dardanët". Ademi për "Telegrafi"-n ka folur për këtë dukuri dhe ka treguar që nga ndeshja me Anglinë do të ketë ndryshime në blerjen e biletave. "Në ndeshjen ndaj Anglisë një person mund t'i blejë vetëm dy bileta dhe jo tri si më parë. Arsyeja është që duam t'ua japim mundësinë sa më shumë tifozëve që ta shohin Kosovën", ka thënë Ademi, i cili ka folur edhe për fillimin e mbledhjes së informacioneve në terren nga Prokuroria për shitjen e biletave. "Federata është e hapur për çfarëdo lloj ndihme që mund t'i japë prokurorisë në lidhje me dyshimet rreth shitjes së biletave. Ata i kanë numrat tanë të federatës dhe mund të na kontaktojnë për çfarëdo informate", ka shtuar Ademi.

# Ndërroi jetë boksieri amerikan



NJU JORK, 17 TETOR - Patrick Day nuk ia del. Boksieri amerikan i peshave të mesme ndërroi jetë për shkak të goditjes që mori në tru gjatë duelit me Charles Conwell javën e kaluar. Lajmin e hidhur e dha promotori i Lou DiBella. 27-vjeçari iu nënshtrua ndërhyrjes kirurgjikale pasi u mposht me "Knock- out" në raundin e 10 në "Wintrust Arena" të Chicagos. "Në emër të familjes, të skuadrës së Patrickut dhe njerëzve të afërt të tij, lutemi dhe shprehim mbështetjen dhe dashurinë për Pat". Day u rrëzua dy herë në tapet, gjatë duelit, para se të humbte me "knock-out". Conwell i dha një goditje të fortë me të djathtën pas veshit dhe një të majtë në nofull. 27-vjeçari mori ndihmën e parë për disa minuta në ring, për t'u dërguar më pas me urgjencë në spital, ku mbërriti në gjendje të vetëdijshme, por më vonë situata u përkeqësua. Mjekët bënë gjithçka për ta mbajtur në jetë, por Day u dorëzua pas disa ditësh.

## SHKURT

### Mabetex Prishtina debuton me humbje në garat ndërkombëtare

Kampionia e Kosovës në basketboll te femrat, Mabetex Prishtina, ka debutuar në garat e FIBA Euro Cup Women. Vashat prishtinase janë mundur në udhëtim nga skuadra ruse, MBA Moscow, me rezultat 90:58 (27:14, 20:14, 27:10, 16:20). Kjo ishte ndeshja e parë në këto gara për basketbollistet e Prishtinës, që synojnë të fitojnë përvojë nga garat ndërkombëtare, kurse dihet forca e skuadrave kundërshtare që kanë një buxhet shumë më të madh dhe kanë më shumë përvojë në arenën ndërkombëtare. Sidoqoftë, vashat prishtinase kanë dhënë maksimumin, derisa fituan çerekun e katërt 16:20. Danisha Shaw kishte 16 pikë, 11 kërcime e nëntë asistime, derisa u dalluan edhe Irma Konjusha me 14 pikë dhe Nyilah Myers me 13 sosh. Te skuadra ruse u dalluan Anastasia Logunova me 19 pikë dhe 12 kërcime dhe Elizaveta Komarova me 20 pikë. Mabetex Prishtina ndeshjen e parë në shtëpi do ta ketë ndaj Spartës më 24 tetor. Më 31 tetor e pret Beshiktashin, si dhe më pas e pret MBA Moscowin më 7 nëntor. Dy ndeshjet e fundit do të jenë si mysafirë, ndaj Spartës më 27 nëntor dhe më 5 dhjetor ndaj Beshiktashit. Dy ekipet e para kualifikohen tutje.

### Moto GP rikthehet në vendin e karnavaleve pas 18 vjetësh

Në vitin 2022 botërori i Moto GP do të ketë një garë edhe në Brazil. Gara e fundit e zhvilluar në këtë shtet daton në vitin 2004. Lajmin e konfirmuan drejtuesit e Dorna (kompania e Moto GP), që bën me dije se ka arritur një marrëveshje 5-vjeçare me Rio Motorsports. Gara e Çmimit të Madh të Brazilit do të zhvillohet në zonën e Rio Motorpark (Rio de Zhaneiro), një pistë që pritet të përfundojë në vitin 2021. Pista do të jetë e gjatë 4,5 kilometra, me 7 kthesa në të majtë dhe 6 në të djathtë dhe një xhiro pritet të zgjasë 1'38".

### Interi planifikon rikthimin e Ibrahimoviqit

Pas lëndimit të Alexis Sanchezit, Interi po planifikon transferimin e një sulmuesi. "La Gazzetta dello Sport" raporton se klubi italian ka tri objektiva për repartin e sulmit. Rikthimin e Zlatan Ibrahimoviqit, i cili është pjesë e Los Angeles Galaxy. Në opsion është edhe Keita Balde, kurse zgjedhja tjetër mund të jetë edhe transferimi i Mario Mandzukiqit nga Juventusi. Sulmuesi kroat nuk ka hapësirë të mëdha në skuadrën e Juves, por do të jetë vështirë që ky klub ta lejojë largimin e tij drejt një rivali të drejtpërdrejtë për titull.

### Ozili: Nuk largohem nga Arsenali

Mesut Ozil u ka dhënë fund thashethemeve për të ardhmen e tij, duke thënë se nuk e ka ndërmend të largohet dhe se do të mbetet tek Arsenali deri më 2021. Shumë klube evropiane, por edhe nga Kina dhe MLS, kanë shprehur interesim për mesfushorin gjerman, por Ozil ia ka mbyllur derën duke thënë se do të mbetet tek Arsenali. "Jo. Unë kam një kontratë deri në verën e vitit 2021 dhe do të qëndroj deri atëherë. Kur firmosa marrëveshjen e re mendova shumë me kujdes për të dhe thashë se ishte një nga vendimet më të rëndësishme të karrierës sime futbollistike. Nuk kam dashur të qëndroj vetëm një ose dy vjet më shumë. Kam dashur të angazhoj të ardhmen time tek Arsenali dhe klubi donte që unë ta bëja të njëjtën gjë. Ju mund të kaloni kohë të vështira, si kjo, por kjo nuk është arsye për të ikur dhe unë nuk do të largohem. Jam këtu deri, të paktën, në vitin 2021", ka thënë Ozili.



| | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | Autor: GAZMEND MORINA | KËNGËTARI DHE AKTORI AMERIKAN NË FOTO (shqip.) | VIJË E PËRKULUR SI LAK, VIJË E LAKUAR | INSTITUCION I LARTË SHKENCOR | SHTET NË AZI (pashq.) | IGLI TARE | PEMË FRUTORE ME KURORË TË GJERË E TË DENDUR | SHKRIMTARI .... SHEHU | MOÇALI, LIGATINA | TERRITOR I IMAMIT (sh.shq.) | MOLDE | I RI ZATETUR |
| | | | | | | RENDITJA | | | | | | | | | | | |
| | | | | | | SËMUNDJE E FËMIJËVE, QË SHFAQET ME SHTREMBË-RIMIN E ESHTRAVE | | | | | | | | | | BASHKËT. / SMIRË | |
| | | | | | | FLUTURUESI I PARË SIPAS MITOLOGJISË (pashq.) | | | | | AKTORI TURK IMIRZALIOGLU (shq.) / TRAJNERI FATIH ..... (Galatasaray) | | | | | | |
| | | | | | | SHIKOJ DIÇKA PËR NJË KOHË TË GJATË; KUNDROJ | | | | | | OBJEKTI I BISEDËS (sh.shq.) / REGJISORI KRYEZIU | | | | | |
| | | | | | | BOR, RENIUM | | | | SHKRONJA TË NJËJTA / FJALË E RËNDË, E PAHIJSHME | | | THEMBRA E KËPUCËS | | | | |
| | | | | | | SHKRIMTARI GJERMAN ERIK MARIA | | | | | | | SULM, MËSYMJE / I SPËRKAT ME UJË | | | | |
| | | | | | | ZANORE | | PARAARDH-ËSI YNË / KËNGËTARJA MEKSIKANE RUBIO | | | | | | ERBIUM, URAN | | | |
| EPOKA E RE | SHKËMB SHUMË I FORTË | TMERR | I MBAROVA, I PËRFUNDOVA | NËNNDARJE E NJË LIGJI | ALUMIN | ULSION POL | | | BAR PËR TË DALË JASHTË / I DOBËT; I PAFUQI | | | | | TOTENHAM / TOROLLAKU | | ZANORE / I PISTË | |
| DELTINA E BARDHË A E KUQE, ARGJILA | | | | | | MUZIKANTI .... KRASNIQI / ILAZ KODRA | | | | | KRAHINË NË SHQIPËRI / ILUZIONISTI SHQIPTAR NADIR .... | | | | DY BASHKË-TINGËLLORE / FUTBOLLISTI DIARRA | | |
| KRYENGRI-TËSI | | | | | | | KUNDREJT NGJITEM / FEMRA LUFTËTARE QË NUK MARTOHEJ | | | | | SHËNIM NË FUTBOLL / SHKËMB I PËRBËRË PREJ RËRE TË NGJESHUR | | | | | DIÇKA E MËRZITSHME, NGAQË PËRSËRITET GJITHNJË (shq.) |
| ➛ | | | | | ÇELIKOSUR / DY BASHKË-TINGËLLORE | | | | | | | | SECILA NGA TRAJTAT E NDRYSHME QË MERR EMRI / INFERMIERE PËR FOSHNJA | | | | |
| PRIFT HEBRAIK / RRJETË E TENISIT | | | | HAITI | | LLOJ AVIONI USHTARAK / PËRFAQËSI DIPLOMATIKE (hist.) | | | | FUTBOLLISTI SPANJOLL SERGIO ..... / PIKTORI I FAMSHËM PABLO ...... | | | | | | BASHKËT. / JOD, ELEKTRON | |
| INTENSITET, TITAN | | | | SKICË / MA JEP | | | | | SHTET I VOGËL NË AMERIKË / NAIM OSMANI | | | | | | | | |
| LUMË I MADH NË HUNGARI | | | | | THIRRJA E MYEZINIT / I BËRË GATI | | | | | | BANOR I NJË SHTETI AZIATIK / MASHKULLI I PARË | | | | | | |
| EPOKA E RE | QË ËSHTË I LIRË NË MENDIME | SHOK (spanj.) / ANËTARËSIM NË NJË ORGANIZATË (shq.) | | | | | | VEGËL MUZIKORE / ZANORE | | | | | | | | INTER / MALI MË I LARTË NË TURQI | |
| NOTË MUZIKORE | | | POLITIKANI FERID ..... / PUNIM I ARËS | | | | | | AFËRDITA DRESHAJ / FAZAT | | | TINARËT | ZANORE / FRIKACAK | | ZANORE / DY BASHKË-TINGËLLORE | | SFOND SHKRONJASH |
| INSTITUTE DEFENSE ANALYSES | | | | PËREMËR VETOR / KUNDREJT E VJETËR | | | | PIKTORI .... VALLA (shq.) / TRAJNERI ITALIAN ..... SAKI | | | | | | KRIMB I DRURI | | | |
| LLOJ REVOLEJE ITALIANE | | | | | | | NUKLEAR / EMËR I VJETËR PËR VIETNAMIN | | | | | | | PËRFUNDIM NË SHAH / FUTBOLLISTI KROAT KRANJÇAR | | | |
| ARKA SHTETËRORE (lat.) | | | | | | TOKA E BUKËS | | | | PERSIA E SOTME (pashq.) / RAFINERIA E ZAGREBIT | | | | | RAMADAN AVDIU / “A” në mes të dy “M” | | |
| CEREMONITË FETARE | | | | | | DJALI I DJALIT / RODA | | | | | SHTAZOR | | | | | | |
| LLOJ VETURE FRANCEZE | | | | STUHI E FORTË ME ERË DHE SHI / ZANORE | | | | | | | FORCA, FUQIA / RAVENA | | | | | | |
| STROFULL QË BËJNË DISA KAFSHË NË PYLL TË DENDUR | | | | | | MOTAK, QË KA MBUSHUR NJË VIT, NJËVJEÇAR | | | | | | AKTOR KOMEDISH | | | | | |

**Njoftimi për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Idriz Seferi"**
Komuna: **Kaçanik**
Data: **18.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/C1.3/025- ESIP/SDG/025-** | **Furnizim me TI- llaptop** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: **SHFMU "Idriz Seferi" Bob, Kaçanik**.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   - **Llaptop 6 copë**

*2.* Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

***3.*** Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: : **SHFMU "Idriz Seferi" Bob, Kaçanik,** më së largu deri më **28.10.2019.**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Florije Zeneli-Berisha**
**Telefoni: 044/656-419**
**E-maili: florijezeneli@gmail.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Deshmoret e Vrrinit"**
Komuna: **Prizren**
Data: **18.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/84-CS/1.2 | Trajnim i mësimdhënësve : Gjitheperfshirja sociale ne arsim dhe aftësim profesional. |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu"Deshmoret e Vrrinit''- Billush, Prizren.** Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin te 1 kontrate për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme ne vitin e fundit.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjajshme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu ''Deshmoret e Vrrinit''- Billush, Prizren, më së largu deri më datën: 25.10.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Ermal Babuna**
**Telefoni: 044/640- 928**
**E-maili: ermalbabuna@gmail.com**

**Njoftimi për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Nazmi Osmani"**
Komuna: **Kaçanik**
Data: **18.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/C1.3/028- ESIP/SDG/028-** | **Furnizim me mjete zërimi** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: **SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj, Kaçanik**.

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme per **Furnizim me mjete zërimi:**
   VOCAL HARMONY PEDAL, 1 Copë
   POWER MIXER, 1 Copë
   SPEAKERS (Autoparlantë), 2 Copë

*2.* Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

***3.*** Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: : **SHFMU "Nazmi Osmani" Elezaj, Kaçanik,** më së largu deri më **28.10.2019.**

4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Jeton Vogliqi**
**Telefoni: 044 649 261**
**E-maili: jvogliqi@gmail.com**

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Bajram Curri"**
Komuna: **Prizren**
Data: **18.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/82-CS/1.4 | Trajnim:Trajnimi i mesimdheneseve ne teknologji informative |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu"Bajram Curri" Romajë, Prizren.** Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e dy kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjajshme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu ''Bajram Curri" Romajë, Prizren, më së largu deri më datën: 28.10.2019** Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Refki Demaj**
**Telefoni: 044/113196**
**E-maili:** refki-demaj@hotmail.com

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

OPSTINA STRPCE
KOMUNA SHTËRPCË
MUNICIPALITY OF STRPCE

Komuna Shtërpcë
Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport
Nr. prot.. 08-030/01-15343/19
Datë: 17.10.2019

Bazuar në Ligjin për Arsim Parauniversitar në Republikën e Kososvës nr. 04/L-032, neni 35; Ligji nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, neni 5; Ligjin e Punës nr.03/L-212, neni 8; Udhëzimin Administrativ 10/2018 dhe 05/2015, Neni 6 (MASHT), Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpallë:

## K O N K U R S

SHML. "Kongresi i Manastirit" Firajë

1. Praktika profesionale/ Hoteleri - turizëm: 10 orë

**DETYRAT KRYESORE**

Të zbatoj detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies.Të përgatis me rregull planin mësimor vjetor, mujor dhe ditor në përputhje me Kurrikulën e në pajtim me kërkesat për përshtatjen e mësimdhënies aftësive dhe prirjeve individuale të çdo nxënësi.

Të ketë njohuri për një repertuor të gjërë të stileve mësimore dhe të jetë në gjendje t`i aplikoj ato që më së miri i përgjigjen situatës në klasë.Të shfrytëzoj në mënyrë efektive resurset që i ka në dispozicion. Të planifikoj, të udhëheqë dhe të vëzhgojë nxënien dhe sjelljen e secilit nxënës.

Të zbatoj metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare. Të krijoj një atmosferë pune dhe discipline, pa përdorur metoda ndëshkimi ose forma të ndryshme të poshtërimit nda nxënësve. Të kontrolloj me rregull dhe të mbaj evidencë për suksesin dhe progresin individual të secilit nxënës si dhe të jetë në gjendje t`i raportoj prindit apo kujdestarit të fëmijës drejt për progresin e arritu të nxënësit sipas kërkesës. Të zgjoj te nxënësit kurreshtjen për të nxënë dhe t`i inkurajoj ata të nxënë në mënyrë të pavarur.

Të kujdeset për zhvilim të vazhdueshëm profesional individual sipas planit të paraparë dhe të kujdeset për realizimin e planifikimit. Të jetë në komunikim të vazhdueshëm me familjen e çdo nxënësi duke realizuar takime individuale me prindër/ kujdestarë të fëmijës.
T`i ndihmojë kolegët për ngritjen e cilësisë së punës.
Të mbikçyrë dhe të udhëzoj nxënësit në procesin mësimor.
Të marrë pjesë në punën e organeve të shkollës.
Të marrë pjesë aktive në përgatitjen e programeve dhe evenimenteve në shkollë, kur kërkohet nga drejtori i shkollës.
Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtëmësimore me nxënës dhe kryej me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të shkollës.
Të tregoj respekt, sjellje kolegiale dhe jodiskriminuese ndaj bashkëpunëtorëve me të cilët punon.
Të mbajë orën e kujdestarisë dhe kujdestarinë ditore.
I punësuari është i obliguar të respektoj kodin e veshjes dhe të sjelljes, të përcaktuar në rregullorën e brendshme të shkollës.

**Kushtet e konkursit:**

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional, sipas **UA. nr. 05/2015 (MASHT) Normativi për mësimdhënësit e arsimit profesional.**

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- Diploma
- Certifikata e lindjes
- Letërnjoftimi
- Vërtetim nga gjykata

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar.

Fleteaplikacionet mirren dhe dorëzohen në objektin e komunës së Shtërpcës, zyra nr. 28

Fleteaplikacionet mirren në DKA ose në shkollë dhe dorëzohen (me dëshmi të verifikuara të kualifikimeve) në objektin e Komunës së Shtërpcës, zyra nr. 28

**Njoftimi për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Razim Cokli"**
Komuna: **Shtërpcë**
Data: **17.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/C1.3/104- ESIP/SDG/104-G/1.1** | **1.Furnizim me paisje për ed. muzikore** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles: **SHFMU "Razim Cokli" Brod, Shtërpcë.**
Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   - ***Mikrofon ajror = 2 copë***
   - ***Mikrofon me kabllo = 2 copë***
   - ***Mbajtëse të mikrofonëve = 2 copë***
   - ***Miksetë Solare Audio profesional = 1 copë***
   - ***Zmadhues 600 Wat = 4 copë***
   - ***Mbajtëse të zmadhuesve = 4 copë***
   - ***Kabllot lidhëse komplet***
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e së paku 2 kontratave për ofrimin e mallrav të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: **SHFMU "Razim Cokli" Brod, Shtërpcë.,** më së largu deri më **25.10.2019.**
4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Bektesh Bajrami**
**Telefoni: 045593226/049929107**
**E-maili: b_24viqa@hotmail.com**

**Njoftimi për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Osman Mani"**
Komuna: **Shtërpcë**
Data: **18.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| **ESIP/C1.3/103- ESIP/SDG/103-** | **Aktivitet garues me nxënës dhe Botimi i** |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e *projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit* (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shkollës "Osman Mani" – Firajë, Shtërpcë.** Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

1. Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
   - ***Aktivitet garues me nxënës ( 1 mikroskop ) dhe Botimi i revistës.***
2. Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
   - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
3. Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën: : **Shkolles "Osman Mani", Firajë, Shtërpcë,** më së largu deri më **28.10.2019.**
4. Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Ganimete Xhemajli**
**Telefoni: 044380029**
**E-maili: gnaimetexhemajli@hotmail.com**

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

**DREJTORIA E ARSIMIT**

Nr-4- 111 – 68281
Datë:17.10.2019

Në bazë të nenit 16 dhe 62 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/040, Ligjit të punës Nr 03/L-212, Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, neni 5 pika C, Statutit të Komunës së Lipjanit, U.A Nr.10/2018 (MASHT) dhe U.A Nr.07/2017 (MPMS), Drejtoria Komunale e Arsimit në Lipjan shpall:

**KONKURS**
**Për plotësimin e vendeve të punës**

**I. SHFMU "Dy Dëshmorët" në Dobrajë e Madhe**
1. Një (1) Zyrtar/e administrativ

**II. SHFMU "Ismail Luma" në Lipjan**
1. Dy (2) Edukator/e për parafillor
2. Një (1) Punëtor/e teknik

**III. SHFMU "Vëllezërit Frashëri" në Lipjan**
1. Dy (2) Edukator/e për parafillor
2. Një (1) Punëtor/e teknik
3. Një (1) Shtëpiak/e

**IV. Çerdhja në Lipjan**
1. Katër (4) Motër edukatore
2. Një (1) Kuzhinier/e-gjellëbërëse

**Kushtet e kërkuara:**
- Përgatitje adekuate profesionale, për stafin profesional (edukator/e, motër edukatore) në bazë të normativit **10/2018 (MASHT),**
- Diplomë (Çertifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës (në formatin **A4**),
- Çertifikata e lindjes,
- Letërnjoftimi – fotokopje,
- Dëshmi se nuk jeni nën hetime.

**Kohëzgjatja e kontratës:** me kohë të caktuar, nga data e pranimit me mundësi vazhdimi pas përfundimit të periudhës provuese.

**Vërejtje:** Pika **I**, pozita **1** dhe pika **IV**, pozita **2**-kërkohet shkollimi i mesëm. Trajnimet eventuale të fushave përkatëse janë të preferuara.

Pika **II**, pozita **2** dhe pika **III**, pozita **2** dhe **3**-kërkohet shkollimi i mesëm i ulët.

**Dokumentet e pranuara nuk kthehen.**

**Njoftim:**
Informimi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhen në Web faqen e Komunës https://kk.rks-gov.net/lipjan/ dhe në tabelën e shpalljeve.

Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbime me Qytetar në Komunë në sportelet **Nr.1-2** dhe dorëzohen në të njejtën vend, bashkë me dokumentet për konkurim. Aplikacionet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen. Konkursi mbetet i hapur **15** ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik.

**Drejtori i DKA-së**
**Rasim Hasani**

**Kërkesa për shprehje të interesit**
Emri i shkollës: **"Vëllezërit Frashëri"**
Komuna: **Prizren**
Data: **18.10.2019**

| Numri i kontratës: | Emri i kontratës: |
|---|---|
| ESIP/SDG/91-CS/1.1 | Trajnim i mësimdhënësve : Gjitheperfshirja sociale ne arsim dhe aftësim profesional. |

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe **Shfmu"Vëllezerit Frashëri''- Planejë, Prizren.** Objektivi i nën-komponentit 1.2. (GZhSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulencës të nevojshme: Trajnim: Përdorimi i teknologjisë në mësimdhënie

**Kualifikimet e firmës konsulente:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin te 1 kontrate për ofrimin e shërbimeve të konsulencës të natyrës së ngjashme ne vitin e fundit.
- Përvojë në trajnimin e mësimdhënësve dhe përsonelin e shkollës
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhiten në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve për mësimdhënës në fushën e përdorimit të teknologjisë;

**Kriteret e vlerësimit:**

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulencës nga fusha e ngjajshme (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohen në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).Firmat Konsulente te interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën: **Shfmu ''Vellezerit Frasheri- Planej, Prizren, më së largu deri më datën: 28.10.2019**
Firmat e interesuara të konsulencës mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë:

**Detajet kontaktuese të shkollës:**
**Personi kontaktues: Miran Ferati**
**Telefoni: 049/337-979**
**E-maili: mirock_508@hotmail.com**

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Niki-S Group Gjakovë" Sh.p.k Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, organizojnë:

**DEBAT PUBLIK**

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e argjilës për prodhimin e bllokave dhe produkteve tjera në Jahoc dhe Gjakovë-J e Qytetit komuna e Gjakovës.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 13.11. 2019 në ora 11:00 në hapësirat e restorantit "Jeta" në Gjakovë do të organizohet debat publik nga kompania "Niki-S Group Gjakovë" Sh.p.k Gjakovë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për shfrytëzimin e argjilës për prodhimin e bllokave dhe produkteve tjera në Jahoc dhe Gjakovë-J e Qytetit komuna e Gjakovës.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Alma Musliu, shpall të pavlefshme Dëftesat e ShF "Shaban Jashari" Skenderaj.

▶ Visar Geci, shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit Filologjik, Universiteti i Prishtinës.

▶ Burim Feka, shpall të pavlefshme Dëftesat e SHF "Fehmi Rama" Likoc.

▶ Kërkoj shporet për nxehje qendrore me dru të përdorur, që mundet të ngrohe deri 1000 m2, numri kontaktues 044-608-626.

▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përku-jdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndër-tim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

▶ Lëshoj banesë me qera në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

Bazuar në vendimin numër 2/848 datë 17.10.2019 të Senatit, njoftohen të gjithë të interesuarit se në datën 25.10.2019, prej orës 10:00, në Fakultetin Ekonomik (amfiteatrin e vogël), kandidatja MSc. Behrije Ramaj-Desku, i nënshtrohet mbrojtëspublike të Punimit të Doktoraturës me temën: "Procesi i strategjisë së e-mar-ketingut ne industrinë e turizmit- Rast Studimi Kosova dhe Shqipëria". Mentor i temës është Prof.Ascc. Dr. Fatos Ukaj dhe Visar Rrustemi-anëtar i komisionit, Prof. Dr. Klodiana Gorica -anëtar i jashtëm i komisionit (Universiteti i Tiranës-Shqipëri).


MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues


ROYAL CROWN
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
(Listed in alphabetical order)
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
RC cola
0.5L